


HEJZA



Mario Vargas LLOSA

Midis prirjes për t'i ikur botës e jetës reale dhe për t'u hedhur në botën e përfytyrimeve dhe ushtrimit konkret të letërsisë, shtrihet një humnerë, që shumica e qenieve njerëzore nuk arrijnë ta kapërcejnë kurrë

Mishel Vinok, historian i shquar francez

SARTRI KA MUNDUR TË JETË VIKTOR HYGO



Mishel Vinoku (Michel Winock), u lind në vitin 1937 në Paris. Ky është fëmija më i vogël (sugari, siç thuhet) nga të pestët sa lindën nëna e tij Zhana dhe i ati Gastoni. Edhe pse i lindur në Paris, Misheli, sipas të dhënave biografike që gjenden në librin e tij të kujtimeve, "Zhana dhe të afërmit e saj", u rrit në "lagjen e kuqe" në Arkej (Arcueil). Kështu, pas shkollimit shumë të suksesshëm në gjimnazin Lakanal, merr maturën me notë shumë të lartë në filozofi. Më pastaj regjistrohet në Hypokhâgne dhe pa shképutje nga puna ndjek studime me korrespondencë.

Pasi merr gradën doktor i shkencave të historisë, në vitin 1961, ai e nis karrierën në arsim, në një shkollë të mesme në Monpëlje për të vazhduar në gjimnazin Osh (Hoche) në Versaj dhe më pas në gjimnazin Lakanal në So (Sceaux). Pas reformave që bëri Edgar Fori (Edgar Faure) në vitin 1968, vit kur u hap edhe universiteti në Vensënë edhe Mishelit iu çelën dyert për në arsimin sipëror. Krahas kësaj Misheli me shumë dashuri e energji krijuese njëherazi u dha edhe në fushën e botimeve veçmas në botime revistash siç janë revista *Esprit* (Fryma), *Recherches* (Kërkime), *Historia* (*L'Historique*), etj. Në shtëpinë botuese *Seuil* (Pragu), në vitin 1962, në fillim bëhet këshilltar pastaj më vonë edhe drejtor i botimeve letrare.

Në vitin 1979 në Universitetin e Sorbonës, në shkencat politike, zgjidhet asistent e më vonë edhe profesor, duke i kaluar shkallë-shkallshëm të gjitha gradat e parapara me ligjet gjegjëse. Duke qenë historian i rryer i specializuar për historinë e Republikës franceze si dhe atë të lëvizjeve intelektuale e politike, Misheli ka shkruar dhe botuar mbi pesëdhjetë vepra. Në mesin e veprave që patën më së shumti sukses e që autorit i sollën edhe çmime prestigjioze janë: "Shekulli i intelektualëve" në vitin 1997 në gjininë e esesë që ia sollti çmimin "Medicis"; "Zëri i lirisë" në vitin 2001 i shpërblyer me çmimin Gober të Akademisë franceze

apo edhe "Zonja de Staël" në vitin 2010 që u kurorëzua me çmimin Gonkur për biografi si gjini që Mishelit i fle fort në shpirt. Temat e trajtuara përfshinë fusha të ndryshme, kështu ato roken me socializmin, antisemitizmin, nacionalizmin, lëvizjet e të djathtës ekstreme në Francë, etj. Në universitet Misheli ligjëron lëndë të ndryshme. Njëra ndër ato që më së shumti është shquar është Historia e ideve politike. Përmes një intervistë dhënë revistës "Kronikat", Misheli jep një historik të shkurtër, duke e portretizuar Zhan-Pol Sartrin, jetën, bëmat, veprimtarinë dhe veprat e tij. Vetvetiu shtrohet pyetja: Çka ka mbetur prej Sartrit sot?

Zhan-Pol Sartri vdiq dhe u varros në varrezat e Monparnasit më 19 prill 1980. Gjatë ceremonisë së varrimit, shkruajnë kronikat e kohës, një turmë e konsiderueshme prej më tepër se tridhjetë mijë vetash, vetvetiu, natyrshëm dhe në mënyrë fare të çiltër ishin mbledhur për të përcjellë trupin e pajetë të tij. Kortezhin e përmortshëm të këtij njeriu që e pati lëvizur e dinamizuar një periudhë të tërë të jetës intelektuale dhe politike franceze, dhe jo vetëm, që me të drejtë njohësit e mirëfilltë dhe studiuesit e kanë quajtur "Vitet e Sartrit".

Kronikat:- Si pranohet sot vepra e Sartrit? Çka ka mbetur sot nga ajo?

Mishel Vinok:- Në veprën e Sartrit mund të dallojmë tre aspekte veçuese, edhe pse ato janë ndarje të papërshtueshme: Sartri filozof, Sartri shkrimtar dhe Sartri "politik". Nuk është filozofia e Sartrit e vetmja gjë që ka mbetur sot si vlera më e shquar nga vepra e tij, e cila edhe pse nuk studiohet gjithaq nëpër universitete në Francë, ajo ndërkaq zë hapësira studimi jashtë Francës, veçmas në ShBA, në Belgjikë dhe në Gjermani. Për këtë ftohje a dalajeji ndoshta do të duhej kërkuar shpjegime në vetë faktin që Sartri, duke mos pasur karrierë universitare, pra edhe nuk mund të përkiste asnjë shkollë legjitimimi të karrierës në këtë

fushë. Kjo gjë është për të shprehur keqardhje, megjë sigurisht që ka ende shumë gjëra për të marrë e për të nxënë aty e sidomos në veprën "Qenia dhe hiçi", që është vepra me shumë originalitet, bartëse copëzash ndodhish e bëmash letrare, një monument i rëndësishëm që ia vlen të vizitohet. E të njëjtës rëndësie është edhe vepra "Kritika e mendjes dialektike" që paraqet vështirësi për t'u lexuar, ambientimi i të cilës kërkon njohje më të përgjithësuar të Sartrit, me një fjalë lypset të pajtohen gjërat me një përpjekje shpresëhumbur, por të madhërishme si dy terme historike të papajtuësime, siç janë liria dhe kolektivizimi. Historia në mënyrë gjithëpërfshirëse ka treguar se socializmi real ishte ndërtuar kundër lirisë së njerëzve. Andaj ky libër i vëllimshëm sot më nuk përllogaritet ndër arsyet e këtij dështimi. Vetëm gjenerata e gjashtëdhjetë e pesëvjeçarëve ka ruajtur vërtetë kujtimin e koncepteve sartriane, edhe pse këto më nuk kanë rrjedhë të përhershme.

Kronikat:- Çka ka mbetur sot nga Sartri shkrimtar?

Mishel Vinoku:- Sartri shkrimtar është sa novelist po aq edhe romancier e shkrimtar pjesësh teatrore. Në këtë laryshi ka edhe shumë gjëra që hidhen apo edhe sosh të papërfunduara. Teatri veçmas është shumë i pabarabartë dhe shpesh lidhet me rrethana gjegjëse. Sidoqoftë, dy pjesë mbeten megjithatë të veçanta: "Me dyer të mbyllura" dhe "Lavirja e respektuar". Për mua, kryevepër e Sartrit shkrimtar është vepra "Fjalët", një libër i shkruar mrekullueshëm e mjeshtërisht prej një shkrimtari madhor. Nga ana tjetër romanet "Neveria", "Muri" dhe mbi të gjitha "Rrugët e lirisë", roman ky me një natyralizëm që në kohën kur u botua bëri bujë, janë vepra që sot ende të bëjnë për vete. Në veprën e fundit shkrimtari flet për kohën e tij duke rrokur çështje e mëdha, të cilat prekin njëherazi edhe ekzistencën edhe politikën. Këtu shihet pritja nga lufta ku njerëzit e flashkët mrekullohen nga poshtërsitë e veta. "Fletoret nga lufta e çuditshme" si vepër na grish ta shoqërojmë Sartrin në front me shokët e tij të pafat, të ndajmë me atë vetë vizionin për luftën që e urrente, por që më pastaj e tumirte. Këtu do të përmendim edhe veprën "Situatat", në të cilën ai është vetë dëshmitarë i madh i kohës dhe thur e qëndis kështu me talent e ndjenja portretet e mrekullueshme të Zhidit (Gide), Kamysë (Camus), Merlo-Pontysë (Merleau-Ponty) e të Nizanit (Nizan). Edhe përkundër përmbyesjes së klerarkisë Sartër/Bovuar, të cilën e hasim sot si arsye e arsytim i feminizmit, pioniere e kësaj fushe e që autores së veprës "Gjinia tjetër" i pranohet borxhi, megjithatë në sytë e mi mbetet e dukshme dhe e shquar se shkrimtari i madh është vetë Sartri.

Kronikat:- Çka mbetet sot nga animet dhe angazhimet politike të Sartrit?

Mishel Vinoku:- Në politikë, Sartri shpesh e ka gabuar rrugën. Rejmon

Aroni (Raymond Aron) për të thoshte se ai ishte një moralist i bjerrë në xhunglën politike. Sot do të thuhej se ai nuk kishte kokë politike. Ai vonë u bregos për politikën. Në vitin 1936, ai nuk pati votuar ndërsa demonstratat e Frontit popullor i ka kundruar nga trotuari. Pra, universi i tij është thellësisht individualist. Në periudhën e paraluftës ai ka treguar papjekuri politike. Kur në vitin 1933 në Berlin e merr vendin e punës së Rejmon Aronit, ai do studiojë Hyserlin dhe Hajdegerin. Mirëpo, duke qenë dëshmitar i nxjerrjes së dekreteve të para naziste, ai nuk është prekur. Çdo gjë ka ndryshuar me fillimin e luftës. Me t'u kthyer nga stalagu (kampi i nënoficerëve dhe ushtarëve të zënë robër nga nazistët, përkth.) në vitin 1941 ai hap një farë klubi diskutimesh, duke formuar kështu grupin Socializëm dhe Liri. Penda e tij bëhet dëshmitar i frymës së tij të rezistencës. Pjesa teatrore "Mizat" (Les Mouches) që u luajt në teatrin Cité (teatri Sarah Bernhardt i arrijanzuar) që e mbështeti Komiteti kombëtar i shkrimtarëve mbetet të konsiderohet megjithatë pjesë teatrore e Rezistencës. Artikujt e tij në revistën "Letrat franceze" (Les lettres françaises) e më vonë edhe në "Beteja" (Combat), veçmas gjatë ditëve pas çlirimit të Parisit, forcojnë statusin e tij prej shkrimtari të Rezistencës, gjë që atij ia sollti ftesën për në ShBA ku ai do të shpalojë gjerë e gjatë këtë rol. Tani e tutje ai e konsideron veten shkrimtar i angazhuar. Si teoricien i letërsisë në veprën "Çështje letërsia?", ai shkrimtarit i vë përgjegjësi të mëdha ndoshta si rrjedhojë e një përplotësimi që lidhet me të kaluarën e tij. Mirëpo, tani më ai nuk do të ndryshojë. Në vllugun e luftës për angazhim politik nga tetori i vitit 1945 pafundësisht do të lëshohet tërësisht në aventurë me revistën "Kohërat moderne" (Les Temps modernes), revistë kjo e angazhimit politik dhe intelektual.

Kronikat:- Pra, tash e tutje ai do të jetë i angazhuar rreth çështjes së komunizmit, qendër e një numri të madh intelektualësh të asaj periudhe ku do të zhvillohet edhe angazhimi i tij...

Mishel Vinok:- Çështje e vërteta, shumë intelektualë tani bëhen anëtarë të Partisë komuniste e cila mbledh 30% të votave. Sartri shkalafitet e kaçanduket. Duke qenë partizan i një socializmi i cili nuk e tjetëron lirinë, ai refuzon rreshtimin pas njërit apo bllokut tjetër, atij komunist apo kapitalist. Kështu, në vitin 1952 lufta e Koresë e futë atë të rrëshqas dhe të aderojë në komunizëm. Ai bëhet "bashkudhëtar" i Partisë, veprimin e së cilës ai e konsideron të patjetërsueshëm për t'u dhënë një vetëdijësim klasor proletarietit në anën e të cilit u reshtua. Ai qëndron në Bashkimin Sovjetik ku si duket mpleks çështjen me një farë makiavelizmi here-herë vajtues e të dhimbshëm. Viti 1956 është viti i të gjitha zhgënjimeve kur gjatë kongresit të XX të Partisë komuniste, Hrushçovi akuzon tmerrret e stalinizmit. Do të duhej të pritej ngulfatja e revoltës hungareze që zhgënjimi të përplotëso-

hej tërësisht. Sidoqoftë, Sartri do të ketë ende simpati ndaj partisë, por jo edhe i lidhur si anëtar, për ndonjë dhjetë vjet. Si bashkudhëtar Sartri ka qenë një i munduri rendit të parë. Në këtë periudhë kohore angazhimi i tij në luftën antikolonialiste nuk demantohet. Ai e kundërshton luftën në Algjeri dhe dëshmi për këtë është firmosja e Manifestit të 121 -ëve si dhe paraqitja e tij si mbrojtës publik i rrjetit Xhanson. Nga viti 1968, kur merr një ripërtëritje, kur sërish ndihet më i ri, ai kthehet nga maoistët. Që tani ai nuk është në pararojë dhe jeton e përjeton episode qesharake si ai kur i drejtohet masës së punëtorëve të Bijankurit (paralagje e Paris-it-përkt.) në këmbë mbi një tinar. Kjo është edhe teposhtëza e angazhimit tij.

Kronikat: - Ç'imazh të "Sartrit njeri" historiani mund të paraqes?

Mishel Vinok-Ky mund të jetë imazhi i një njeriu, sharmi i të cilit kaptonte kalërueshëm përtej rrethit të të afërmeve të vet, imazhi i një njeriu me prestigjin e mendimit që shndërronte kapërcyeshëm ndjesitë e dukjes fizike, imazhi i njeriut që nuk e pranonte shoqërinë në të cilën jetonte dhe në të cilën kishte drojë të bëhej bashkëfajtor...Një njeri me zemërgjerësi me themel të cilën Zhan Ko (Jean Cau) e njohu dhe e pranoi në veprën "Skica kujtimesh" me një qasje të lehtë me të rinjtë si antipode të komedisë sociale. Sartri kur nuk e pranonte kompromisin fakt që atë e bëri të jetë shumë pakëz politik në përmasën kur dihet se politika shpesh është gjë tjetër veç se një zinxhir kompromisesh. Qëndrimi i tij ngriste më tepër moral se politikë. Ai e thoshte të Mirën dhe të Keqen. Ai ishte mishërim i një diçkaje shumë të thellë: traditës së refuzimit e të revoltës. Vetëm në një çështje ai nuk ka qenë manisheist (koncept sipas manisheizmit religjion misionar rival i krishterimit deri në Mesjetë që influencoi bogomilët dhe katarët.-perkt.) në çështjen e Lindjes së afërt. Si autor i veprës "Refleksione mbi çështjen hebreje", ai është ndierë me empati të dyfishtë si me izraelitët ashtu edhe me palestinezët. Ky ka qenë mishërim i situatës tragjike dhe ka pasur mirëkuptim për të dyja palët, andaj është pozicionuar me justifikime herë për njëherë për palën tjetër, siç qe rasti me atentatin e Lojërave olimpikë të Munihut apo marrja në mbrojtjeje e izraelitëve, e cila ia solli titullin doktor nderi në Universitetin e Jerusalemit (i vetmi nderim që ka lejuar t'ia bëhet) në vitin 1976. Bilanci përfundimtar i këtij intelektual në refuzim të përherëshëm e i cili i ka parë njerëzit t'ia flaknin iluzionet të cilat edhe vetë i gjakonte, është më tepër negativ. Me talentin dhe fuqinë e tij Sartri ka mundur të jetë Viktor Hygo i shekullit të XX. Mirëpo, siç dihet, Viktor Hygoi vdiq si ngadhënjyes, pasi e pa të lindet e themelohet një Republikë që ai e quante dhe e konsideronte sipas dëshirave të tija, ndërsa Sartri do të jetë më tepër një farë kronisti gjenial i të pamundshmes. Turma që qe e pranishme gjatë varrimit të tij të improvizuar, vetvetiu, i përkulej me nderim jo një profeti të madh, po një refuzuesi të madh. Dështimi i tij si i këtyllë na mëson me rrezatim drite për epokën e tij.

(Përktheu nga frëngjishtja dhe përshtati për shtyp: Xhevat Halili)

Në fokus

VIZIONI PËR KULTURË ELITARE

Avni HALIMI

Secili komb, në secilin shtet, ka figurat e veta emblematike, institucionet e veta që me të drejtë konsiderohen si simbole të krenarinë kombëtare. Natyrisht, në të shumtën e rasteve, këto figura e institucione i përkasin sferës kulturore. Jo rrallë, fjala, qëndrimi, sugjerimi, vlerësimi i tyre bëhen vendimtare për të mirën e shtetit dhe të kombit, bëhen ligj i patejkalueshëm madje edhe për organet drejtuese më të larta të vendit. Kjo është forca e një kombi para së cilës përkulen "zeusët politikë", "herkulët partiakë".

Në ato shoqëri ku në çdo hap e në çdo kohë gëlojnë aktivitetet dhe veprimtaritë jo humane, në ato shoqëri me një demokraci të pazhvilluar e skajshmërisht të brishtë, jo që nuk dëgjohej asgjëkund ai zë emblematik por, fatkeqësisht, artikulesit e këtij zëri janë të ngulfatur deri në shuarje. Kështu zë fill dhe vazhdon sa më gjatë jeta e pseudovlerave kombëtare. Hiç "vlere" e kombit rritet me mynxyrat e kulturës kombëtare tek jep shpirt.

Një komb sa më larg kulturës të qëndrojnë aq më afër injorancës politike do të jetë dhe, sa më injorant politik që të jetë aq më të lehtë e ka shpërfytyrimin në qenie me vlere primitive. Kultura është ajo që i ushqen vizionet, idealet kombëtare që i japin kuptim politikës.

Në Maqedoninë e Veriut të gjithë shqiptarët duan të merren me kulturë, sepse, të gjithë mendojnë se marrja me kulturë sjell përfitime të majme, të gjithë mendojnë se kultura është një tezgë gjigante ku mund të shiten dhe të blihen deri edhe kalbësirat më kutërbuese. Të gjithë i përcjellin aktivitetet limonadë që shiten për kulturë, por, sa herë që shprehet nevoja për ta


ndihmuar kulturën kombëtare, për të nxjerrë në pah personalitete kompetentë që të shprehin brengë dhe vizion për kulturë, të gjithë i rrudhin krahët, të gjithë shprehen si me grahamën e fundit të jetës së tyre duke u arsyetuar me "nuk është koha tani për kulturë"! Strategji brilante kjo e të gjithë atyre që kanë interes ta nënshtrijnë një popull dhe të luajnë pa dhimbje mbi kurrizin e tij.

Të marrësh një post ministror, apo, të arrish që ta bindësh partnerin qeveritar që ta ndihmojë kulturën shqiptare në Maqedoninë e Veriut, është ngjashëm sikur t'ia mbash dikujt shpirtin gjallë duke i dhënë ujë me bisht të lugës. Të shprehësh kënaqësinë për disa aktivitete kulturore do të thotë të vetëpajtohesh për të qëndruar miliona kilometra larg botës së profesionalizimit dhe institucionalizimit të jetës së mirëfilltë kulturore. Pra, kultura shqiptare në Maqedoninë e Veriut nuk ka nevojë për ndihma prej institucioneve përkatëse shtetërore por, ka nevojë për një strategji kombëtare, për një plan zhvillimor si dhe për buxhet konkret shtetëror. Këto tri elemente shumë shpejt do të bëhen digë për lumin e politikave diskriminuese maqedonase, sepse elementët kulturorë janë në rritje e sipër, fakulteti i arteve pranë USHT-së tash e sa kohë është duke prodhuar kadro kulturore, po ashtu edhe fakultetet e tjera shoqërore. Potenciali kreativ kulturor shqiptar është në rritje e sipër përkundër thellimit të hendekut në mes të tyre të subjekteve politike e shtetërore. Shtimi i këtij potenciali në njëherë anë dhe, rritja e moskokëçarjes politike në anën tjetër, do të jenë shkak-tare të shkëndijave të një konflikti të paevitueshëm ndëretnik në Maqedoni. Do të nisë si një "revolucion kulturor" i

cili, në historinë e njerëzimit, gjithnjë ka hasur në simpati, në përkrahje dhe në madhërim nga shoqëritë e civilizuara.

Subjektet tona politike janë të themeluar dhe duhet të funksionojnë ekskluzivisht në mbrojtje të të gjitha tipareve që e përbëjnë identitetin kombëtar. Identiteti kulturor është dhe duhet të jetë bazë e veprimtarisë së tyre kombëtare. Le të merren të gjithë me kulturë, le të prodhojnë të gjithë kulturë, le të kënaqen të gjithë me kulturë, ngjashëm si në sport: një komb sa më masivisht që merret me sport aq më i shëndetshëm do të jetë por, megjithatë, trupat reprezentative, pra përfaqësuesit e kombëtares, flasin për seriozitetin e kombit në këtë sferë. Edhe në kulturë, populli duhet t'i ketë përfaqësuesit e vetë reprezentativë, qofshin këta institucione apo individë profesionistë që me dinjitet dinë t'i mbrojnë dhe t'i artikulojnë vlerat kombëtare. Veprimet amatore në kulturë janë si ato sporte që zhvillohen në rrugë: ndonëse kanë atraktivitetin e vet nuk flasin për kurrfarë vlere sportive kombëtare.

Elita politike e shqiptarëve të Maqedonisë duhet të ketë të qartë se ka ardhur koha edhe për një elitë kulturore shqiptare. Bashkëjetesa e këtyre dy elitave si dhe bashkërendimi i veprimeve të tyre do të fliste për një pjekuri dhe për një perspektivë të bujshme kombëtare. Elita kulturore shqiptare në Maqedoni gjithnjë do të ishte pararojë e çështjeve kombëtare ndërsa do të ishte edhe rufe mbi të gjithë ata që mundohen të na e shesin sapunin për djathë. Në suaza të intereseve kombëtare, elita kulturore perceptohet si legjislativi ndërsa elita politike si ekzekutivi kombëtar.



KULTI I GJARPRIT TË SHTËPISË

Gjarpri si simbol i plleshmërisë, i rojës së shtëpisë dhe vatrës, apo si hyjni ktonike, me shumë elemente është i lidhur me kultin e Diellit

Prof. Asoc. Dr. Falmur DOLI

Ndër kultet më të veçanta dhe më të rëndësishme, nga mbijetojat e kompleksit të hyjnive mbrojtëse të shtëpisë, bënë pjesë edhe kulti i gjarprit. Ky kult në arealin e Ballkanit na paraqitet shumë herët, që nga periudha parahistorike e neolitikut. Mirëpo, me paraqitjen e ilirëve në këtë truall, rëndësia e këtij kulti ngrihet deri në atë masë sa që merr rol dominant në sistemin mitologjik dhe religjioz të ilirëve të jugut. Ndërkaq, gjarpri si simbol i plleshmërisë, i rojës së shtëpisë dhe vatrës, apo si hyjni ktonike, me shumë elemente është i lidhur me kultin e Diellit. Kulti i Diellit, tek ilirët, sikundër edhe tek popujt e tjerë, në këtë shkallë të zhvillimit, ishte themel në të gjitha manifestimet religjioze. Thuhet se ai u zhvillua më shumë në viset veriore ilire. Edhe përkundrejt sfidave të mëdha gjatë historisë, ilirët e ruajtën kompaktësinë e traditave të tyre kulturore. Fryma konservative në ruajtjen e kulteve të të parëve të tyre, pastaj vetëdija dhe shpirti i pathyeshëm i ilirëve, bëri që këto besime religjioze të ruhen deri në ditët tona. Për rrjedhojë, siç do të provojmë në vijim, kulti i gjarprit edhe në besimet popullore të shqiptarëve paraqitet si i veçantë. Ndër shqiptarët, gjarpri është i lidhur fort me shtëpinë dhe familjen. Ndaj, në rite e besime popullore shqiptare, gjarpri paraqitet si hyjni mbrojtëse e jetës, e mirëqenies dhe mbarësisë në familje.

Ornamentet nga kulti i gjarprit, varësisht nga periudha historike, u aplikuan në teknikë të ndryshme, me paraqitje artistike figurale realiste apo në stilizim abstrakt gjeometrik. Paraqitja artistike figurale-realiste me tipare plastike haset që nga neoliti, siç është rasti me figurinën e gjarprit prej terakote, me tipare unike në gjithë kompleksin neolitik ballkanas-anatolik. Kjo figurinë arkeologjike u zbulua në shtresën kompakte të argjilës së një shtëpie në vendbanimin neolitik "Tjerrtorja", në




fig. 3

periferi të Prishtinës. Trupi i gjarprit të fragmentuar, të cilit i mungon koka, është i zbukuruar me incizim zizag të shoqëruar nga të dyja anët me therje vertikale (fig. 3.). Pa dyshim se ky gjarpër shërbente për

qëllime kulti.

Më pas, me formimin e etnikumit ilir, gjarprin me paraqitje figurale realiste e hasim edhe tek byzlykët prej argjendi, të cilat u gjetën në një varrezë të çiftit princor ilir, në Banjë të Pejës, shek. VI-V p.e.s. Tiparet formësuese të këtij artefakti ilir



fig. 4

(fig.4.), përkatësisht të byzlykut, i cili në dy skajet e tij përfundon në formë kokash gjarpri me paraqitje realiste, janë shprehje e futjes së paraqitjes figurale në artin ilir që nga faza e hershme e periudhës së hekurit. Natyrisht se, motivi i gjarprit rrënjët e tij të thella i ka në religjionin ilir.

Kjo bëri që kulti i gjarprit në mitologjinë ilire të ruhet në një vijimësi të pakëputur deri në ditët tona. Prandaj, ishte e natyrshme që në vitin 2001, gjatë gërmimeve arke-



fig. 1



fig. 2

ologjike në një qendër ilire në Kosovë, përkatësisht në vendbanimin ilir të Çifllakut, shek. I-II i.e. sonë, të zbulohet paraqitja figurale e gjarprit e skalitur në një bllok mermere në teknikë të relievit të ulët - të dalë nga sipërfaqja e gurit.

Kështu, në fig.1., jo rastësisht, është paraqitur dukja e gjarpërit të vërtet, Vipera berus, nga familja e gjarpërinjve Viperiadae, nepërkave helmuese, e cila e popullon gjithë territorin paleoarktik, pra edhe pjesën dërrmuese të territorit, dikur të banuar nga ilirët, kurse sot nga shqiptarët. Mbështetur në vërtetimet analitike - krahasuese kuptojmë mirëfilli se kokat e gjarpërit tek byzlyku ilir kan një strukturë formësuese figurale e cila në gjithë tiparet e saj, deri në hollësi, i riprodhon ato të gjarpërit të vërtet të zënë ngoje më sipër. Për më tepër, kjo specie e gjarpërit, nuk shërbeu si mostër për t'i

riprodhuar tiparet natyrale - reale të saj, vetëm nga artisti i periudhës së hekurit, porse ai shërbeu edhe për mjeshtrin e periudhës më të lashtë - neolitike, siç është rasti me figurinën e gjarpërit prej terakote, paraqitur në fig.3. Këtu, mjeshtri i kësaj periudhe, pjesën e sipërme, shpinën e gjarpërit prej terakote, e zbukuroi me incizime zigzage të shoqëruara nga të dyja anët me therje vertikale, me radhitje të rregullt, zbukurim ky që i shëmbëllen në tërësi larave të shkruara në shpinën e gjarpërit të vërtet të llojit Vipera berus, paraqitur në fig. 1.

Poqëse e bëjmë një kërcim të madh kohor, në diakroni të eksitencës së pandërprerë të këtij kulti të gjarpërit, do të shohim se ai me paraqitje figurale realiste mbijetoi deri në ditët tona edhe në besimet popullore shqiptare. Në formë figurale realiste gjarpri u aplikua edhe në artefaktin etnografik shqiptar, paraqitur në fig. 2. Madje, ç'është me shumë rëndësi, gjarpri i paraqitur në fig. 2., punuar nga vajza drenicase me penj (tekstil) dhe rruaza dy ngjyrëshe, gati se në tërësi i shëmbëllen gjarpërit të vërtetë paraqitur në fig.1. Edhe në këtë rast, shpina e gjarpërit (fig.2.), sikundër tek

traditë që vajzat para martesës ta punonin për pajë (prikë), dhe natën e dhëndërisë ta varnin në mur të "çilerit", prej nga nuk e largonin më. Kjo dukuri, si mbijetoi e besimit pagan, ndër shqiptarë u ruajt gjithandej, ngase kjo kafshë ktonike, përveç tjerash, simbolizonte edhe plleshmërinë e gruas.

Paraqitja figurale e gjarpërit në funksion të rojës së shtëpisë

Po kështu, gjarprin në arkitekturën



fig. 8

popullore shqiptare me paraqitje artistike figurale punuar në hekur dhe aplikuar në funksion të rojës së shtëpisë, e hasim edhe në dyert e portës së madhe të oborrit të shtëpisë së familjes ZHERKA në Gjakovë (fig. 6., fillimi i shek. XX). Strukturën formësuese e funksionale të rezës së hekurit, për mbylljen e dyerve të mëdha të oborrit të kësaj shtëpie, e sajojnë dy gjarpërinj, paraqitur në formë realiste me stilizim të thjeshtësuar. Njëri syresh, siç shohim nga fig. 6., është i formësuar në mbarim të pjesës plloçake të përzgatur të rezës, e cila, në teknikë të incizimit, është e zbukuruar në formë vijash zigzage në tri radhë, prej të cilave radha e mesme, nga të dyja anët, është e shoqëruar me trekëndësha në një ritëm të rregullt. Po këtë formë strukturale të shprehjes artistike të gjarpërit, simbolizuar me stilizim abstrakt gjeometrik, në formë të vijës zigzage të shoqëruar në të dyja anët me trekëndësha, e hasim edhe tek stela ilire e Sinjit (Kroaci), me emra ilirë PAIO e CUIO, shek. I i.e. sonë (fig.8). Në këtë stelë ilire, ornamentin e kultit të gjarpërit është paraqitur në një kompozim artistik gjeometrik së bashku me



fig. 6



fig. 13

ornamentin e kultit të Diellit në formë ylli-rozete gjashtë-rrembëshe brendashkruar në rreth.

Po kështu, disa shekuj më pas, në mesjetën e hershme të periudhës arbërore (shek.VI-VIII të e. sonë), edhe në broshin e derdhur në bronz na paraqiten së bashku kultit i gjar-

krishtit, dhe në fillim të epokës sonë, tek ilirët, përveç ekzistimit të njësim-it kulturor, mënyrës së jetesës, djegies në tumule apo varrimit, kemi edhe bashkimin e kultit ktonik dhe diellor.

Bashkimi i këtyre dy kulteve mund të shpjegohet edhe me faktin

fig. 17




fig. 12

prit dhe kultit i Diellit. Në pjesën rrethore të kësaj stolie, motivi i kultit të gjarprit është paraqitur në formë të stilizimit abstrakt gjeometrik, përkatësisht në formë të meandrit - vijës së thyer zigzak, e cila e qarkon figurën e një kafshe, në trupin e së cilës janë paraqitur pesë ornamente nga kultit i Diellit në formë të rrrathëve bashkëqendrorë.

Bashkimi i kultit ktonik dhe kultit të Diellit

Paraqitja e këtyre dy kulteve së bashku, në formë të artit gjeometrik, ndodhi në përputhje me periudhën kur paraqitja realiste figurale e kafshës ktonike të gjarprit u alternua me paraqitjen simbolike abstrakte - gjeometrike të saj. Si dhe me kohën kur, sipas studiuesit Gj. MANO-ZISI, në shekujt e fundit të epokës para

se, sipas A. STIPÇEVIQIT, gjarpri nuk ishte vetëm simbol ktonik, porse edhe simbol i plleshmërisë bimësore dhe ishte i lidhur edhe me burimet e tjera të jetës siç ishte Dielli. Në Egjipt dhe në Greqi, gjarpri ndonjëherë paraqitet edhe si personifikim i Diellit. Për rrjedhojë, këto dy kulte të paraqitura së bashku, qoftë në formë të stilizimit abstrakt gjeometrik, apo në formë figurale - realiste, i hasim edhe te ballina e djepit të Rrafshit të Dukagjinit, pastaj tek nëntrarëza dhe shtylla qendrore e ballinës së hajatit dhe në pjesë të tjera të hambarit në fshatin Grashticë, komuna e Prishtinës (fillimi i gjysmës së dytë të shek. XIX), më tej, tek harku i portës së vogël të oborrit të kullës shqiptare të SYLËREXHËVE në Vranoc të Lugut të Baranit (fundi i shek. XIX), më pas, tek kulla e Rexhë FETAHUT në Gurakoc të Istogut (fig.13., gjysma e parë e shek. XIX), tek porta harkore e kullës në fshatin Perlat të Epërm në Mirditë, tek furka e Rafshit të Dukagjinit (fig.17.), tek shtëpia e ndërtuar në mëhallën e Pulajve, fshati Vërmicë (fig.12.), tek guri mbivarror në fshatin shqiptar Vuksan Lekiq të Tuzi (gjysma e dytë e shek. XVII), si dhe tek porta harkore në kullë të Ramadan SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit, (fig.15.), ornamentit i kultit të Diellit në teknikë të relievit të ulët është i skalitur në gurin tjetër të harkut të kësaj porte, shek. XIX, etj.

Interpretimi abstrakt gjeometrik i simbolit të gjarprit

Veç kësaj, aplikimin e ornamentit nga kultit ktonik i gjarprit me interpretim gjeometrik abstrakt të simbo-

lit të tij, qoftë me vetëdije apo pa vetëdije, e hasim në raste të panumërta edhe në objektet e tjera arkitektonike popullore apo etnografike shqiptare. Do të thotë, e hasim të aplikuar edhe në tekstilet popullore shqiptare, përkatësisht tek veshjet e femrave të punuara nga endëset shtëpiake, pastaj tek veshjet e burrave, tek kaptellët e djepit, më pastaj tek arkat e nuseve, tek drugëzat e avlëmendit, tek furkat, tek koshat (koçekët), etj.

Një interpretim gjeometrik abstrakt të gjarprit, aplikuar në teknikë të incizimit në formë zizage, e hasim edhe tek ena dy vegjake prej balte e periudhës së hekurit (shek. IV-V p.e.s.), të gjetur në nekropolën tumulare ilire në fshatin Romaj të Dukagjinit. Po këtë formë abstrakte figurale, siç shohim nga fig.5., e hasim edhe në shokën - kaptellin e djepit të punuar me rruaza me ngjyra, pastaj tek jastëku nga Dukagjini (fig.7.), përreth portës, në ballinë të hambarit në Grashticë (fig.9.), si dhe tek marama me motive të thurura, fundi i shek. XIX, Dukagjinë. Nga vrojtimi i jastëkut nga Dukagjini dhe detajit të fashetës së hambarit në Grashticë, kuptojmë se, përveç përkimeve të plota ndërmjet këtyre dy paraqitjeve gjeometrike të gjarprit, edhe mbarimet e tyre shquhen me një formësim të njëjtë. Kësaj, do t'i shtonim se pikëzimin mes për mes strukturës zigzage në ornamentin e hambarit, si të tillë, e hasim edhe në gjetjet arkeologjike ilire.

Ndërkaq, shokën - kaptellin e djepit me aplikim abstrakt gjeometrik të simbolit të gjarprit në Krahinën e Drenicës e hasim në raste të panumërta. Tek endja dhe zbukurimi i tyre me rruaza, në të gjitha rastet, pashmangshëm, është aplikuar ngjyra e kaltër. Në rastin konkret, me rruaza ngjyrë të kaltër janë formuar trekëndëshat të cilët nga të dyja anët e shoqërojnë meandrin në formë zigzage. Si ngjyra e kaltër po ashtu edhe trekëndëshi janë aplikuar në funksion apotropaik. Objekti etnografik i kaptellit vendoset mbi rrethin e djepit. Në shumë raste, në këtë element të djepit është daltuar gjarpri në formë artistike reale. Në Dukagjin, gjarprin e daltuar kësajsoj e hasim edhe në anën e jashtme të dërrasës anësore të djepit, pastaj në kaptellin e një djepi nga një fshat afër Pejës, si dhe në djepin nga Podguri, pastaj edhe në kaptellin e një djepi tjetër nga Kosova, etj.

Paraqitja e gjarprit në formë artistike reale

Paraqitjen realiste të gjarprit, siç thamë edhe më lartë, e hasim të skalitur në portën harkore të kullës së SYLËREXHËVE në Vranoc (fig.10.), si dhe në një gurë këndor të "shpisë së gatë", në afërsi të portës hyrëse të kësaj kulle, pastaj në elementin harkor të dritares së ndërtuar në nivelin e katit të dytë - në fasadën anësore të kullës së Ali GECIT, Llukë e Poshtme, Deçan fig.16., më tej, tek porta harkore e kullës së Ramadan



fig. 15



fig. 5



fig. 7

SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit (fig.15.), tek porta harkore e kullës së Sadri SALIHIT në fshatin Dubovik të Dukagjinit, tek guri këndor i kullës së Haxhi ZEKËS në Pejë, në fasadën e kullës së Rexhë FETAHUT në Gurakoc të Istogut (fig.13.), tek guri i djathtë - vertikal i kornizës së portës harkore të kullës së Bardhosh DINËS në Dubovik, komuna e Deçanit, etj.

Në këtë kontekst do të veçonim paraqitjen e gjarprit në formë figur-

për shkak të karakterit dhe simbolikës së tyre, këto ornamente gjarpërinjsh u aplikuan përherë në vendet më të ekspozuara, meqë përdorimi i tyre kishte funksion magjik, mbrojtës dhe fatsjellës. Për më tepër, edhe aplikimi i këtyre ornamenteve, kryesisht në formë artistike të relievit të ulët, shquhet për një strukturim kompozicional të harmonizuar organikisht me konceptin estetik formësues dhe





fig. 9

ale - realiste, aplikuar në teknikë të basorelievit (të dalë në formë plastike nga sipërfaqja e gurit). Ky ornament i gjarprit është aplikuar në gurin vertikal të djathtë të portës harkore të njëjës kullë, ndërtuar në lagjen e HOXHAJVE në Junik.

Siç mund të vërejmë nga më sipër,

fig. 16



arkitektonik të ndërtimit popullor, apo elementeve strukturale të tij.

Kulti i diellit dhe i gjarprit

Kështu, tek kulla e SYLËREXHËVE në Vranoc, përkatësisht në harkun e portës së vogël të dverve të oborrit, nëpër të cilën hyjnë anëtarët e familjes dhe mysafirët, janë aplikuar gjithsej shtatë (7) motive dekoruese nga kulti i Diellit dhe i gjarprit (fig.10.). Ndërkaq, tek porta e madhe harkore e oborrit, në pjesën e poshtme të shtyllës së djathtë të saj, si dhe mbi pjesën e majtë të harkut, janë skalitur nga një ornament nga



fig. 10



fig. 14

kulti i Diellit në formë ylli-rozete gjashtërrembëshe brendashkruar në rreth. Po kështu, në fasadën ballore (lindore) të kullës, pranë portës së zënë ngoje, për afërsisht në gurin e mesëm të latuar të këndit të majtë të kësaj fasade, është skalitur edhe një motiv dekorues nga kulti i gjarprit. Në këtë rast, gjarperi i skalitur në këtë gurë, në teknikë të relievit të ulët - të dalë nga sipërfaqja e gurit, bishtin e ka të mbledhur në formë spirale, apo siç thuhet në popull: të mbledhur "katullaç" (fig.14.).

Paraqitja e gjarprit në arkitekturën popullore në format e përsëritura më sipër, përkatësisht skalitja e tij në pozita karakteristike, nga e cila gjarpri "vëzhgon - kontrollon" hyrjen e çdo personi në oborr apo në shtëpi, mirëfilli simbolizon hyjninë mbrojtëse të shtëpisë dhe anëtarëve të familjes. Sipas dëftimeve të shpeshta të Zylia (Gunga) DOLIT, e lindur në dekadën e nëntë të shek. XIX, "bolla e shpisë", e cila qëndronte në gurët e oborrit të madh të shtëpisë së saj, në lagjen e Çabratit të Gjakovës, i njihte dhe i mbronte të gjithë anëtarët e familjes së shtëpisë. Sipas saj, "bollën e shpisë" shpeshherë e shihnin të mbledhur katullaç. Pra, kulti i gjarprit, në besimet popullore shqiptare, si mbijetojë e besimeve të lashta pagane, nuk gjëlloi vetëm në fshat, porse, ai fuqishëm gjalloi edhe në qytet. Përveç kësaj, po ashtu mësojmë se në të kaluarën, gjarpri në rite e besime popullore paraqitet si gjallesë ktonike me attribute totemike.

Totemizmi nënkupton besimin e bashkësive primitive - tradicionale njerëzore se, midis tyre, nga njëra anë, dhe kafshëve dhe bimëve, nga ana tjetër, ekziston një raport

mitologjik në të cilin kafshët e më rrallë bimët, paraqiten në rolin e mbrojtësit të të parit të fisit ose të gjinisë. Kjo dukuri mitologjike që më herët ishte e njohur edhe për ilirët, dhe në vazhdimësinë e saj të pakëputur, mbijetoi edhe në besimet popullore shqiptare.

Në kontekst të përkufizimit të sipërshtuar bënë pjesë edhe kompleksi i ornamenteve me simbolik kultesh të ndryshme, skalitur në kullën e Ramadan SELIMIT në fshatin Krajk të Hasit.

Në portën harkore të kësaj kulle janë skalitur gjithsej 14 (katërmbëdhjetë) ornamente. Pastaj, në njërin prej gurëve këndor të kësaj kulle janë skalitur dy ornamente, ndërkaq në gurin tjetër është skalitur vetëm një ornament. Me këtë rast, nuk do të ndalemi më gjerësisht në shpjegimin veç e veç dhe të plotë të simbolikës së këtyre ornamenteve, por vetëm do të theksojmë se ato i përkasin ornamenteve të kultit ktonik - kafshëve tokësore, pastaj, të kultit të gjarprit, të kultit të diellit, të kultit të kalit, si dhe të kultit të vegjetacionit së bashku me kultin e shpezëve.

Në kuadër të këtij kompleksi ornamentesh me simbolikë të caktuar, në teknikë të relievit të cekët, janë skalitur edhe ornamente të tjera të karakterit astral dhe apotropeik, siç janë gjysmëhëna dhe trekëndëshi, si dhe tri ornamente të tjera nga kulti i mjeshtërive. Së këndejmi, në këtë studim analitik mirëfilli provohet se, kulti i gjarprit është pjesë përbërëse e trashëgimisë komplekse etnokulturore e popullit tonë. Ky kult, në vertikalen diakronike, u zhvillua në një vijimësi të pandërprerë në harkun kohorë që nga ilirët deri tek shqiptarët e kohës sonë.

POETI TETOVAR REMZI

Në përmbledhjen e poezive (Divan) të Remziut ka 19 kompozime kronogramike që e tregojnë qartë se ai ka jetuar në shekullin e 19



Metin IZETI

Në periudhën osmane ka vepruar një numër i madh i poetëve shqiptarë të cilët kanë shkruar poezi në turqishten e vjetër. Pjesa dërmuese e tyre ka lënë gjurmë të konsiderueshme edhe në letërsinë e shkruar në periudhën osmane. Për fat të keq, shumica e tyre, si rrjedhojë e konceptit armiqësor ndaj çdo gjëje që kishte karakteristikë osmane nga pushteti komunist në trojet shqiptare, kanë mbetur të panjohur për nënqiellin dhe letërsinë shqiptare. Mendoj se është padrejtësi ndaj veprimtarëve shqiptarë të kësaj periudhe që veprat e tyre, krahas asaj që nuk kanë qenë në gjuhën shqipe, të mbeten të fshehura dhe të panjohura për auditorin shqiptar. Do të japim disa informata të shkurtëra për poetin shqiptar të shekullit 19 që e ka përdorur emrin poetik Remzi.

Emri i Remziut nuk përmendet në përmbledhjet biografike të poetëve të periudhës osmane, ndërsa për vendlindjen, kohën kur ka jetuar dhe prejardhjen e tij, informohemi nga kronogramet në vargje që i ka shkruar për personat dhe monumentet e kohës kur ka jetuar. Në përmbledhjen e poezive (Divan) të Remziut ka 19 kompozime kronogramike që e tregojnë qartë se ai ka jetuar në shekullin e 19. Në dyvargëshin kronogramik që e ka shkruar në lidhje me restaurimin e kubesë në Mejdandin (objektin e ritualeve të tarikatisë)

bektashi) në Teqenë Harabati Baba në Tetovë nga ana e Rexhep Pashait, sipas llogaritjes numerike të shkronjave (ebxhed) del viti 1225/1810-11 që e tregon qartë se ai në këtë periudhë ka qenë një poet i pjekur, i cili ka arritur pjekurinë për të shkruar vargje kronogramike. Në përkthim të lirë në këtë dyvargësh kushtuar Rexhep Pashës ai thotë:

“Shërbëtor jam, në halle nga ashku ky Remzi e shkroi këtë datë
Ai që ndërtoi këtë vakëf, të mos ketë dert e mundime O Zot i madh”.

Në një dyvargësh tjetër kronogramik, Remziu, e tregon qartë se ka qenë një nga dervishët e Teqesë së Sersem Ali Babait (Harabati Baba) në Tetovë:

“Ky Remzi jam dervish me derte plot dhe shkrova këtë datë
I gëzuar që sërish u rindërtua teqeja e Sersem Ali Baba'së”.

Llogaritja numerike e shkronjave të këtij dyvargëshi është viti 1231/1815-16) dhe e tregon qartë se ai së bashku me dervishët tjerë të kësaj teqeje janë gëzuar për rihapjen për ibadet të teqesë Harabati Baba në Tetovë. Kjo periudhë edhe historikisht përkon me restaurimin e teqesë nga ana e Rexhep dhe Abdurrahman Pashait.

Gjithashtu një kompozicion kronogramik në vargje, poeti Remzi, e ka

shkruar edhe në lidhje me restaurimin e Xhamisë së Larme nga ana e Abdurrahman Pashait. Ai në poezinë që e ka titulluar: Historia e Xhamisë së Abdurrahman Pashait, thotë:

“Pak është edhe një mijë vjet “Mashallah” t'i thuhet kësaj zemre (xhamisë)
Çdo i mençur me mirësi e përmend emrin e ndërtuesit të saj

Më parë ishte një xhami e vogël mëhale
Ishte rrënuar nga koha dhe kishte mbet pas dore

Kësaj here emrin e Abdurrahman Pashait përmende
E gjallëroi sërish ate, harxhoi pasuri të madhe.”

Remziu ka shkruar një kompozicion kronogramik në vargje edhe në lidhje me Urën e Abdurrahman Pashës. Më drejtë, bëhet fjalë për urën që e ka lidhur pjesën e Hamamit të Tetovës me Shtëpinë e Beut dhe Xhaminë e Larme, që sot nuk ekziston. Në poezinë e tij Remziu e thekson se Tetova (Kalkandelen) është e vendosur në rrëzën e malit Sharr dhe lumi Shkumbin e ndanë atë në dy pjesë, dhe kjo urë i bashkon dy anët e qytetit, thotë ai.

Në bazë të kompozicioneve kronogramike është shumë e qartë se Remziu ka jetuar në fillim të shekullit të 19 në Tetovë dhe aty e ka kaluar

jetën. Ai në një dyvargësh flet edhe për fisin e tij, i cili është thirrur Sudë, dhe ka qenë pjesëtarë i tarikatisë Bektashi në Tetovë.

Remziu, gjithashtu, ka edhe një poezi dyvargësh të strofëshe që ua kushton dyvargëshet imamëve, pra bijëve të Pejgamberit a.s..Kjo poezi është titulluar “Munaxhat Med'h-i Duvazde Imam (Përgjërimit dhe lavdërimi i dyvargëshet imamëve). Remziu ka shkruar edhe një elegji (mersije) në lidhje me rënien dëshmorë të Hazreti Huseinit në fushën e Qerbelasë. Kjo elegji e tij është kënduar në ditët e muajit Muharrem në teqenë Harabati në Tetovë.

Remziu, siç e thekson në poezitë e tij, ka shkruar poezinë për të shprehur ndjenjat e dashurisë ndaj Zotit dhe si rrjedhojë e frymëzimit nga ithtarët e të vërtetës (ehli hakikat). Gjithashtu në disa vargje e ka theksuar se poezia është forma më e mirë nëpërmjet të cilës ka mundësi të futet në kallëpe ndjenja dhe emocionimi shpirtnor dhe dashuria ndaj Zotit. Ai thotë:

“Pena e poetit i derdh perlat e dalura nga nishani faqes së të Dashurit

Ai e lavdëron, më zëra të ndryshëm, vetëm faqen e të Dashurit”.

Në vargjet e shkruara në turqishten e vjetër, nga Remziu, shpeshherë haset në gabime gjuhësore që e tregon qartë se ai ishte shqiptarë. Divani (Përmbledhja me Poezi) në dorëshkrim i Remziut, që gjendet në Bibliotekën Kombëtare në Shkup, si çdo vepër e kësaj periudhe, fillon me “Bismil-lah” dhe më pas vazhdon me një poezi lavdëruese për Pejgamberin a.s.. (Na't-i Sherif-i Server-i Kainat Mefhar-i Mevxhudat Muhammed Mustafa). Divani i Remziut ka 30 kaside, 302 gazele, 4 katërvargëshe, 14 pesëvargëshe, 17 gjashtëvargëshe, 1 dhjetëvargësh dhe në total ka 309 poezi. Të gjitha poezitë janë të rihuara.

Poeti Remzi, sipas fjalëve të tij, nuk pretendon të jetë një "poet i mirë". Përkundrazi, ai është një dervish i sinqertë që e vuri penën e tij në dispozicion të mendimit të fesë. Pavarësisht kësaj, ai është një poet që njeh traditën dhe herë-herë e shpreh zotësinë e tij në estetikën e letërsisë klasike. Poezia dhe gjuha e tij i ngërthen veçoritë lokale, ai hedh dritë mbi periudhën dhe rajonin ku ka jetuar, veçanërisht me poezitë e tij historike të shkruara në stilin e lëvdatave. Përkushtimet e shkruara ndaj poezive të poetëve të kohës së vet të lënë përshtypjen se ai lexonte poetët e shquar dhe se ishte në kontakt me disa poetë të periudhës së tij, si Kenziu, Hulusi, Handiu e të tjerë.

GËNJESHTRA QË FSHEH TË VËRTETËN E THELLË

Midis prirjes për t'i ikur botës e jetës reale dhe për t'u hedhur në botën e përfytyrimeve dhe ushtrimit konkret të letërsisë, shtrihet një humnerë, që shumica e qenieve njerëzore nuk arrijnë ta kapërcejnë kurrë

Mario Vargas LLOSA

1.
Në rast se nuk gabohem në hamendësimin tim (ndonëse edhe mund të ndodhë të gabohem), një burrë apo një grua zhvillon para kohe qysh në fëmijëri apo herët në vitet e adoleshencës, prirjen për të ëndërruar njerëz, situata, histori, botë të ndryshme nga bota ku jeton dhe kjo lloj prirjeje është shenja e parë e asaj që, më pas, mund të quhet prirje letrare. Natyrisht, midis prirjes për t'i ikur botës e jetës reale dhe për t'u hedhur në botën e përfytyrimeve dhe ushtrimit konkret të letërsisë, shtrihet një humnerë, që shumica e qenieve njerëzore nuk arrijnë ta kapërcejnë kurrë. Ata që e kapërcejnë këtë humnerë dhe që, përmes fjalës së shkruar, bëhen krijues botësh, janë shkrimtarë, pra, ajo pakicë që ka mundur t'i përforcojë prirjet apo tendenat në saje të ushtrimit të vullnetit, të cilin Sartre e quante zgjedhje. Në një çast të caktuar, këta njerëz vendosën të bëhen shkrimtarë. Ata zgjedhën vetë të bëjnë një gjë të tillë. Ata u përpoqën të ndërtonin një jetë, ku fjala e shkruar të kthehej në qendër të shtysës së tyre të brendshme, të mbajtur deri atëherë nën frë, me anë të së cilës ata do të përpunonin më pas jetë dhe botë të tjera në hapësirat mjegullore të mendjeve të tyre.

2.
Cila është zanafilla e kësaj prirjeje të kahershme, e burimit të prirjes letrare për të shpikur qenie dhe rrëfenja? Përgjigja, mendoj, gjendet te rebelimi. Jam i bindur se ata që zhyten në hulumtimin e jetëve, të ndryshme nga e tyra, tërthorazi vënë në dukje mospranimin dhe kritikën e jetës ashtu siç është, të botës së vërtetë, duke shfaqur dëshirën për ta zëvendësuar atë me krijimet e përfytyrimeve dhe të ëndrrave të tyre. Ndryshe, përse dikush që është mjaft i kënaqur me realitetin, me jetën e vërtetë, ashtu siç e jetojmë, do t'i përkushtohet diçkaje aq të palëndshme dhe fantastike, siç është të krijuarit e realiteteve imagjinare?!

3.
Natyrisht, ata që rebelohen kundër jetës kështu siç është, duke përdorur aftësinë e tyre për të sajuar jetë dhe njerëz të ndryshëm, mund ta bëjnë këtë për një mori arsyesh, të ndershme apo të pandershme, bujare apo egoiste, komplekse apo banale. Natyra e vënies në diskutim të thelbit të realitetit, që për mendimin tim qëndron në themel të çdo thirrjeje të brendshme letrare, nuk ka aspak rëndësi. Ajo që ka rëndësi është se mospranimi i realitetit duhet të jetë aq i fortë, sa të nxisë entuzi-

azmin për një detyrë kaq donkishoteske sa vënia në lëvizje e mullinjve të erës – zëvendësimin e kollajtë të botës së jetës konkrete, objektive ashtu siç e jetojmë, me botën e hollë dhe eterike të letërsisë. Gjithsesi, pavarësisht nga karakteri jetëshkurtër i letërsisë dhe nga natyra subjektive, figurative dhe jashtë-historike e produktit të saj në praktikë, ajo arrin të ketë efekte afatgjata në botën e vërtetë, me fjalë të tjera, në jetën e njerëzve prej mishi dhe gjaku. Vënia në pikëpyetje e jetës reale, që përbën arsyen e fshehtë të ekzistencës së letërsisë, të profesionit letrar, bën që letërsia të na japë një vizion të veçantë të një periudhe të caktuar. Jeta që përshkruhet në letërsi (veçanërisht në letërsinë e nivelit të lartë), nuk është asnjëherë thjesht jeta që kanë përfytyruar, shkruar, lexuar apo përjetuar ata që e kanë shkruar; ajo është një barasvlerës letrar që ata kanë qenë të detyruar të krijojnë, duke qenë se nuk kanë mundur ta jetojnë në të vërtetë dhe, si rrjedhojë, kanë pranuar ta jetojnë atë në mënyrën më subjektive dhe më të tërthortë që mund të jetohet: me ëndrra dhe letërsi.

4.
Letërsia është një gënjeshtrë që fsheh një të vërtetë të thellë: është jeta ashtu siç nuk ka qenë, jeta siç donin ta jetonin burrat dhe gratë e një epoke të caktuar, por që nuk e jetuan dot, kështu që u është dashur ta shpikin nga mendja. Ajo nuk është fytyra e Historisë, përkundrazi, është ana e kundërt ose ana tjetër e saj: është ajo që nuk ka ndodhur dhe, si pasojë, duhej të fabrikohet me mendje dhe fjalë, për të realizuar ambiciet që jeta e vërtetë nuk mundi t'i plotësonte, për të mbushur boshllëqet që gratë dhe burrat shihnin përreth tyre, të cilat ata u përpoqën t'i mbushnin me fantazma të vetëkrijuar. Natyrisht, ky rebelim është relativ. Shumë shkrimtarë nuk janë aspak të vetëdijshëm për këtë dhe, në rast se do të ndërjegjësoheshin për rrënjët kryengritëse të thirrjes së tyre të brendshme për të shkruar, ka të ngjarë të habiteshin dhe të frikësoheshin, pasi në jetën e tyre publike, sigurisht, nuk u ka shkruar ndonjëherë ndër mend se po komplotojnë fshehurazi për të hedhur në erë botën ku jetojnë. Nga ana tjetër, rebelimi i tyre është mjaft paqësor. Fundja, ç'të keqe ka t'i kundërvësh jetën imagjinare jetës reale? Ku qëndron rreziku në një garë të tillë? Në vështrim të parë, nuk ka asnjë rrezik. Është thjesht një lojë, apo jo? Dhe lojërat nuk mendohen se janë të rrezikshme për sa kohë që nuk kanë të ngjarë t'i kapërcejnë kufijtë për t'u përzier me jetën e vërtetë. Natyrisht, kur dikush, Don Kishoti



apo Zonja Bovari, këmbëngul të përziejë letërsinë me jetën dhe rreket ta bëjë jetën të ngjashme me letërsinë, pasojat mund të jenë shkatërrimtare. Kësisoj, loja e letërsisë nuk është e pafajshme. Fryt i pakënaqësisë së thellë me jetën e vërtetë, letërsia është vetë burim pakënaqësish dhe shqetësimesh. Ata që me anë të leximit jetojnë një histori të madhe – si dy historitë që përmenda më sipër, të shkruara nga Cervantes-i dhe Flaubert-i – vijnë në jetën e vërtetë me një ndjeshmëri më të madhe ndaj kufizimeve dhe papërsosmërive të saj, të ndërgjegjësuar prej krijimeve të mrekullueshme të fantazisë së tyre për faktin se bota e vërtetë dhe jeta siç e jetojmë, janë mjaft më mediokre se jeta e shpikur prej romancierëve. Kur lexuesi përballet me jetën e vërtetë, turbullimi i ngjizur nga një letërsi e mirë, në rrethana të caktuara, mund të kthehet në akte rebelimi kundër autoriteteve, institucioneve apo bindjeve të rrënjësura.

5.
Kjo është edhe arsyeja se përse Inkuizicioni spanjoll u druhej

veprave letrare dhe ia nënshtrohte ato censurës së fortë, duke shkruar deri aty sa t'i ndalonte ato, për treqind vjet radhazi, në kolonitë amerikane. Preteksti ishte se këto rrëfime çmendurake mund t'ua hiqnin mendjen indianëve nga adhurimi i Zotit, që ishte shqetësimi i vetëm serioz në një shoqëri teokrate. Ashtu si Inkuizicioni, të gjitha qeveritë dhe regjimet që aspirojnë të kontrollojnë jetën e qytetarëve të tyre, kanë shfaqur të njëjtin mosbesim ndaj letërsisë dhe ia kanë nënshtuar atë kontrollit të fortë dhe qethjes së quajtur censurë. Asnjëri prej këtyre autoriteteve nuk është gabuar: i pafajshëm, për sa mund të duket, të shkruarit e historive letrare është një mënyrë e të ushtruarit të lirisë dhe të kundërvënies së njerëzve. atyre të fesë apo njerëzve laikë, që dëshirojnë ta zhdukin atë. Kjo është arsyeja përse të gjitha diktaturat, fashiste, komuniste apo regjimet fundamentaliste islamike, tiranitë afrikane apo latino-amerikane, janë përpjekur ta kontrollojnë letërsinë, duke e futur atë më pahir në xhakatën mbyhtëse të censurës.

LETËRSIA E FIKSIONIT TË DYFISHUAR

Duke folur për Dushin, autori empirik flet për veten, për të tjerët për një kauzë, e cila ishte përvijuar nëpër honte të thella shpirtërore, për t' u bartur nëpër organizime të fshehta e për të shpërthyer më vonë si refuzim politik

Adriatik ZEQIRI

Palimpsest Dush Kusarit u shkrua në kohën kur në Kosovë më kishte rënë sistemi i diktaturës komuniste jugosllave dhe kishte filluar shtypja dhe dhuna e një sistemi me tipare fashiste, që kishte për qëllim pastrimin e Kosovës nga shqiptarët. Tashmë censura nuk kishte kuptim, ngase shfarosja kishte marrë një dimension tjetër, jo atë të tjetërsimit dhe të futjes në binarët e sistemit monist, por kishte kaluar në totalitetin e saj më të egër të mundur, eliminimin fizik. Andaj edhe fjala tashmë ishte e drejtpërdrejtë përderisa arrinte të shfaqej. Ajo nuk ishte më e mbuluar me figurë, dhe tashmë nga diskursi alegorik i viteve '70 e '80, kishte kaluar te diskursi i dëshmisë, dokumentimit të së shkuarës së hidhur dhe reflektim i të ardhmes nëpërmjet historisë. Kjo do të thotë të mos dalësh nga natyra fikionale e shkrimit letrar, megjithatë duke kaluar nëpërmjet zhanreve e diskurseve që po i përgjigjeshin një kohe tjetër të shfaqjes artistike.

"Mirëpo, deri te ky roman shtresat autobiografike janë mbuluar me figurë, qoftë si pasojë e frikës nga censura, qoftë për hir të polisemantikës së tekstit letrar (ideal i letërsisë) ngjarjet e jashtme të viteve '90, kur ndodh rënia e sistemit të centralizuar dhe nis dhuna e hapur, të cilat ndikuan që së paku të hapet diskursi intencional. Kjo hapje diskursive, sidomos për trajtimin e temave me shenja nacionale, te Teki Dërvishi hap mundësinë që të përforcojë lirshëm shtresat autobiografike të tekstit të vet, duke mundësuar që më të mos ketë nevojë në krijimin e "diskurseve mashtruese", por të diskurseve më të etabluara letrare me shenja më të forta autobiografike. Nuk ka më nevojë të përdoren figurat si Shtëpia e sëmurë (burgu), Thashë (dëshmi), Herezia (individualiteti karshi rendit) për të mbuluar shkrirjen e individualitetit krijues në figurën si mbulim, por tashmë lind kërkesa për të shkruar letërsinë si amalgam i fuqishëm i interdisiplinaritetit zhanror: dëshmi, biografi, fikcion që do të thotë shkrimin e tekstit përkushtues për shokun e burgut Kadri Kusarin".

Pra, romani Palimpsest Dush Kusarit nga Teki Dërvishi vjen si një përkushtim për mësuesin e shkollës së mesme, heroin e rinisë së autorit, Kadri Kusarin, me shtresëzimet autobiografike të cilat janë ato që e karakterizojnë fabulën. Rrëfimi i kohës së shkollës së mesme që lidhet direkt me lëvizjen patriotike në Kosovë të fundviteve '50 dhe viteve '60, me personalitete të kësaj lëvizjeje, ku figurë kryesore e njohur ishte Adem Demaçi. Në fakt, teksti hapet me një shkrim që autor e ka Adem Demaçin, i cili i kushtohet heroit të romanit Kadri Kusari. Adem Demaçi, shkrimtari i ri i asaj kohe, e pastaj figura përfaqësuese e rezistencës kundër pushtuesit komunist jugosllav, e thotë fjalën e pari. "Kadriu ishte më i miri ndër ne". Kështu përfundon teksti hyrës i romanit, si një nevojë e jashtëzakonshme për konfirmim, për heroin që do të tregohet, për krijimin e një bindjeje të brendshme.

Kadriu ishte më i miri ndër ne, kjo është edhe vija diskursive e fabulës, në një rrëfim në vetë të parë, si gjithmonë në prozën e Teki Dërvishit, i cili është shurnë më afër dëshmisë e autobiografisë, duke i hapur rrugë diskutimeve formale. Statusi i tekstit nga autori mbetet i papërcaktuar, duke aluduar në një formë të re të fikcionit që kujtim Rrahmani do ta quante si prozë postmoderne. "Kapitujt e aktet e ndryshme të romanit "Palimpsest Dush Kusarit", kanë emërtimet e zhanreve dhe varianteve të ndryshme të shkrimit, si: Pergamenë, Ornament, Palimpsest, Fletore, Rekuier, Libër i humbur, Fotodosje, Portret, Varianti i amshimit e ndonjë tjetër, emërtime këto që definojnë shpesh edhe prirjen përkatëse të modusit të caktuar për situatën përkatëse. Mirëpo, këto emërtime, në shikim të parë zhanrore, prezantojnë edhe akte të veçanta

ngjarjesh të jetës së heroit dhe jo vetëm të atij, duke e shqiptuar kështu veçanërisht dimensionin historik të kohës, shovinizmin dhe totalitarin përnjëherësh, të shtetit që funksionon në kohën dhe hapësirën e romanit. Bashkë-dyzimi i modelit pergamenë të shkrimit, me narracionin e idealizuar e fragmentar, me eseizmin dhe hulumtimin e tipit biografik, këtë prozë e bëjnë postmoderne në kuptimin e plotë të kësaj fjale".

Prozë postmoderne për nga elementet, por gjithashtu edhe ndër të parat që kishin të bënin me një letërsi që kishte filluar të shkruhej në gjuhën shqipe, letërsinë e burgut ose më saktë fikcionin dokumentar, një tip autobiografie artistike, e veçantë për nga forma, por e përhapur shumë në vendet postdiktatoriale, ndoshta një nevojë e tmerrshme për të treguar, për të dëshmuar vuajtjen dhe shtypjen e përjetuar, për të krijuar Librin e historisë kombëtare, nëpërmjet aktit individual të heroit.

"Këto biografema për kronikën historike të Kosovës janë evidenca të pamohueshme, ashtu siç janë të tilla qindra e mijëra të tjera për martirët e shumë të ne. Por, për autorin Teki Dërvishi e dhëna apo evidenca historike nuk mjafton për mikun e bashkëvuajtësin. Mbi konceptin aristotelian se poesis-i është më filozofik sesa historia, Dërvishi, të dhënës historike i jep shpirtin letrar: dëshminë e qëndrësës, të vuajtjes dhe të pësimin. Duke e njohur biografemën se Kadri Kusari ishte albanolog dhe në fletoret e tij kishte ravijëzuar impresione letrare, Dërvishi, mjeshtër i sinkretizimit të formave, hyn në botën e

palimpsestit apo të rikrijimit të tyre, qoftë me anë të kujtesës, dëshmisë apo atribuirimit, duke e shndërruar tekstin fundor si komunikim letrar, politik e nacional me Dushin, të tjerët dhe vetveten."

Pra, që teksti është fikcion autobiografik nuk ka dyshim, por që në paratekstin e tij e shpallë edhe tendencën për një dyfishim, për krijimin e një iluzionit të një dëshmie të dokumentuar, shkrimin e një teksti mbi një tekst tjetër, ose më saktë identifikimin e gjurmëve të një teksti të mëhershëm duke bërë kështu palimpsest. "Shkrimi kur të vihet mbi shkrimin, shkrimi të ri kur i vihet stoli shkrimi i vjetër, i thonë - palimpsest."

"Duke qenë se palimpsesti në teorinë e shkrimit letrar nënkupton një hipotekst (nëntekst) dhe një hipertekst (mbitekst), që do të thotë dy shkrime, një të dhënë e një autorial; del sheshit tendenca që vepra të marrë trajtën e sprovës, të veprës që mbështetet në të dhënë për jetën, për rrethun, për autorin dhe për personazhin e veprës. Kjo, madje, mund të hutojë lexuesin naiv e të besueshëm, që veprën ta shohë si monografi për Dush Kusarin, qoftë edhe me artikullimin e tekstit që në disa nivele e merr trajtën e esesë."

Në këto kurthe mund ta çojë lexuesin vetë autori me lojën e vet krijuese, me vetëdije të plotë apo duke iu shtruar udhës kah e shpie shkrimi i vet letrar. E vërteta është se edhe këtu ngjet paradoksi, si jo njëherë në letërsi, për t' u dëshmuar tanimë edhe në shqip: se letërsia autobiografike sado e ushqyer nga iluzioni i tekstit referencial, në të vërtetë është letërsi e

fikcionit të dyfishuar."

Pra, Palimpsest Dush Kusarit, është tekst autobiografik, me heroin Kadri Kusarin në qendër të rrëfimit dhe një rrëfim në vetën e parë si përkushtim për idealin e rezistencës ndaj sistemit, për mësuesin dhe ideologun historia e cila duhej të tregojë tashmë. Më herët kemi sjellë një konstatim se edhe teksti alegorik është në vetvete autobiografik kur kemi sjellë disa interpretime të romanit të Teki Dërvishit Herezia e Dërvish Mallutës, megjithatë tash te Palimpsesti, Dërvishi kalon nga alegoria, nga figura te dëshmia, te dokumentimi, nga personazhet simbole te personat simbol, pra është momenti i rileximit të një teksti të mëhershëm siç duket, andaj edhe shumë shenja barten nëpër tekst në pozicion krahasues për të kryer detyrën e dekodimit të tyre në nivelin stilistik e semantik gjuhësor, duke dhënë shansin për të rikrijuar kuptimet e teksteve të mëhershme. Përsëri do të shfaqet Shtëpia e sëmurë, por tashmë me referencë të drejtpërdrejtë për burgun, pra e zbuluar si figurë ose njeriu i cili vdes i ri dhe shumë të tjera si këto. Pra, është një lloj çelësi për të lexuar edhe njëherë letërsinë e Teki Dërvishit. Në fakt, lehtë mund të identifikojmë qëllimin e shpërfaqjes së ideve aitoriale për fenomenet dhe për ngjarjet në tërësi, si të momentit, si ato historike nëpërmjet një teksti artistik. "I lirë, si i vdekur." Robi bëhet i lirë vetëm në çastin kur është i vetëdijshëm për robërinë e tij."

"Pra, duke folur për Dushin, autori empirik flet për veten, për të tjerët për një kauzë, e cila ishte përvijuar nëpër honte të thella shpirtërore, për t' u bartur nëpër organizime të fshehta e për të shpërthyer më vonë si refuzim politik".

Nysret Krasniqi në studimin e tij për romanin në veprën Letërsia e Kosovës 1953-2000, do t' i bëjë një ndarje dypjesëshe romanit, duke konstatuar dy momente të rrëfimit që bartin edhe ngarkesa të ndryshme edhe stilistike: "Por, lexuesi i vëmendshëm i këtij libri do të hetojë dy blloqe intencionale, të pashpallura, në këtë libër. Del se pjesa e parë e librit, nëpërmjet jetës së Dush Kusarit si albanolog shpërfaq edhe konceptin e autorit Dërvishi për individualitetin artistik, vetminë e artistit, vuajtjen e tij karshi sistemit uniform të vlerave ideologjike, dhunën shpirtërore e fizike ndaj tij, për ta shënjuar maksimën e njohur se veçantia paguhet e nuk shpaguhet kurrë."

Ndërsa, pjesa e dytë e kësaj proze më tepër del fikcionalizimi i fakticitetit të burgimit të Kadri Kusarit dhe të burgosurve tjerë, për ta shndërruar këtë pjesë në përvijim emocional të vuajtjes dhe qëndrësës së njeriut shqiptar, atij njeriu i cili duke e pranuar aktivizmin nacional ka sakrifikuar jetën e tij."

Pra, edhe njëherë i kthehemi asaj që e quajtmë boshti i diskutit të fabulës, Dushi ishte më i miri nga ne, për të dhënë edhe intencën aitoriale të krijimit të heroit model, për atë që duhet të bëhet në përpjekjen për realizimin e të drejtave nacionale dhe njerëzore, pra heroin e rezistencës ndaj sistemit totalitar shtypës e shovinist.

Dushi ishte frymëzimi dhe libri i parë, si violinë e parë në ndërtime dhe orkestrës së madhe të librit të Historisë Kombëtare, ku faqet e tij të djegura e të shkatërruara kërkonin palimpsestin që po e bënte Teki Dërvishi, nga arkivat e kreativitetit të tij, simbolika e një laboratorit të mrekullueshëm ku po "kopjo-heshin" tekstet e ngjarjeve të një kohë të rezistencës e mbijetesës. Libri që Tekiu po shkruante, nuk ia kishte borxh vetëm Dushit, mësuesit të tij po edhe bashkëluftetarëve të idealit me të cilët kishte përjetuar burgun qysh herët, që dalin të radhitur në faqet e këtij libri, librin të cilin Teki Dërvishi e kishte filluar qysh herët, qysh nga filltet e shkrimit të tij.

PS. Poshtëshënimet për shkaqe teknike janë mënjantuan

Teki Dërvishi Palimpsest Dush Kusarit

ROMAN | BOTIMI I DYTË



BOTIMET
NOA

DËSHMIA E NJË KOHE TË PAKOHË


(Mbi romanin "Në Tiranë bie shi" të Kliton Nesturit)

Zyrafete SHALA

Romani "Në Tiranë bie shi", i botuar nga Shtëpia Botuese OMSCA-1, është vepra e nëntë me radhë në krijimtarinë e Kliton Nesturit, i dëshmuar tanimë në letrat shqipe si poet, prozator, publicist e dramaturg. Duke qenë nga brezi i shkrimtarëve që në hapat e parë të ndërtimit të identitetit të tyre krijues, u përballën me shembjen e një epoke sfillitëse dhe fillimin e një tjetre përplot stuhie, Kliton Nesturi me kohë përvetësoi shkathhtësinë e vrojtimit të thellë të dukurive, situatave e problemeve shoqërore të kohës. Krahas prirjes së tillë, që e njohim nga veprat e mëparshme, në këtë roman autori spikat edhe me mjeshtërinë për të depërtuar nëpër labirintet e errëta të shoqërisë shqiptare, aty ku shpeshherë janë tulatur forcat shkatërruese, në pritje të një periudhe të përshtatshme për të shpërthyer.

Romani "Në Tiranë bie shi" trajton realitetin aktual shqiptar me tërë absurditetin e tij, krizën morale të shoqërisë, përpjekjet e individit për të mbrojtur dinjitetin, si dhe vështirësitë e ruajtjes së vlerave humane në një shoqëri kaotike. Rrëfimi, në vetën e parë, rrjedh natyrshëm në një linjë fabulare që herë-herë ndërpritet nga episodet retrospektive, të cilat i përplotësojnë informacionet rreth personazheve, dhe nga digresionet, që e pasurojnë më tej temën e trajtuar. Ndërthurja e elementeve të tilla kompozicionale dhe funksionalizimi i tyre brenda tërësisë e shton dinamikën e rrëfimit, krahas paraqitjes së botës së brendshme të kryepersonazhit, dilemave, pandehmave dhe filozofisë jetësore të tij. Në këtë mënyrë, krijohet një ekuilibër mes kompozicionit dhe konfliktit, i cili gjithnjë paraqitet nga perspektiva e protagonistit, dhe ashtu i thjeshtë e pa dramacitet, jep mundësinë e shpalosjes së karaktereve të ndryshme njerëzore që ndërveprojnë mes tyre. Në përgjithësi, ky ndërveprim përshkohet nga një tendosje emocionale e fuqishme, intensiteti i së cilës ndryshon varësisht nga situatat e krijuara.

Edhe pse në qendër të konfliktit shfaqet dinamika e ngjarjeve brenda një kompanie bankare, që në të vërtetë është dinamika e tërë sistemit shtetëror në miniaturë, autori gjen mjete që tablonë e realitetit ta jep në përmasa më të gjera. Ai ndërthen fate, përvoja e përjetime të shumta që rezultojnë nga të jetuarit në një shoqëri kaotike, ku çdo gjë ka vlerë më të madhe se jeta e njeriut. E të jetuarit në një shoqëri të tillë, ku liria e veprimit bëhet peng i hipokritëve dhe mediokërve, doemos sjell ndjeshmërinë e poshtërimin dhe të qenit skllav në një botë moderne, në një botë ku heronjtë vdesin më shpejt se sa fama e tyre që përmbledhet në pak rreshta letër. Nga shoqëria e stërngarkuar me probleme, objektivi i shkrimtarit fokusohet



het më tej te familja, si qelizë e shoqërisë, që vuan qoftë nga bartja e frustrimeve nga mjedisi i jashtëm, apo nga mangësitë në ndërtimin e marrëdhënieve ndërpersonale.

Personazhi kryesor i romanit, është një intelektual që në pamundësi për të ndryshuar realitetin, tërë potencialin e vet duhet ta orientojë në mbrojtjen e integritetit, parimeve dhe vlerave të veta personale. Jo rastësisht, autori nuk i vë emër kryepersonazhit, sepse ai është vetëm njëri nga shumë intelektualët shqiptarë të kohës sonë, të cilëve, deshën apo jo, u duhet të jenë dëshmitarë të devijimeve dhe keqpërdorimeve që bëhen në emër të pushtetit. Për këtë gjendje është i vetëdijshëm edhe vet personazhi, që në një rast shprehet: "Unë jam një i panjohur në mesin e turmës miliardëshe të 'heronjve të heshtur', një njeri i paemër prej atyre që nuk kanë rastin kurrë të lënë gjurmë në historinë e njerëzimit, por që u mjafton të jetojnë jetën pa i vënë emrin e askujt tjetër".

Çështjet me të cilat preokupohen personazhet, në dukje janë të zakonshme, të përditshme, por janë pikërisht ato që po e ngulfasin tërë shoqërinë shqiptare, duke mos i lënë

shteg për progres. Brenda faqeve të romanit gjejmë artistin që me punën e tij nuk arrin të sigurojë një jetë normale për vete dhe familjen, gjejmë gazetarin që i zhgënjyer nga jeta jepet pas bixhozit dhe alkoolit, gjejmë njerëz me oreks të pakufishëm për pushtet që nuk i zgjedhin mënyrat për të arritur ngritjen në pozitë, gjejmë edhe të tjerë që sakrifikojnë lidhjet familjare për përfitime sado të vogla, por gjejmë edhe njerëz që udhëhiqen nga dashuria dhe janë këmbëngulës në kërkimin e një jete më të mirë. Me një fjalë brenda romanit shfaqet aktualiteti shqiptar me të gjitha plagët dhe dhembjet e tij. Përjetimet dhe situatat nëpër të cilat kalojnë personazhet e romanit, aq sa janë të tyre, janë edhe të secilit prej nesh, prandaj te lexuesi krijohet ndjesia se gjithçka po ndodh rreth tij.

Derisa kryepersonazhi shpalosë botën e tij përmes përsiatjeve mbi jetën, botën, marrëdhëniet ndër-njerëzore dhe veten, personazhet e tjera njihen përmes dialogëve dhe relacioneve që kanë me të. Secili nga këta personazhe përfaqëson një segment të jetës dhe shoqërisë, prandaj secili në mënyrën e vet merr pjesë në ndërtimin e imazhit të

së sotmes. Ata i shohim tek lëvizin brenda një shtjelle destruktive, forcën e së cilës e krijon shoqëria e zvetënuar nga normat morale e njerëzore. Kjo forcë i tërheq brenda vetes dhe synon t'i çekuilibrojë, në veçanti ata që nuk duan t'u nënshtrohen ligjeve të saj. Të tilla janë pjesa dërmuese e karaktereve të këtij romanit, të cilët, pavarësisht nga barra që u ka ngarkuar fati, përpigën të ecin në drejtim të kundërt me rrjedhën e lumit të shoqërisë, të vetëdijshëm që edhe nëse nuk mund të bëjnë asnjë hap tutje, së paku të mos e shtojnë fuqinë e asaj rrjedhe të gabuar.

Forca e brendshme e karaktereve të romanit dhe vendosmëria e tyre për të qenë kundër devijimeve të shoqërisë, shfaqet në sfondin e romanit edhe përmes muzikës, rok-ut, që glorifikohet si rebelim paqësor ndaj jetës. Rock-u del të jetë një mekanizëm mbrojtës për të neutralizuar pakënaqësinë dhe zhgënjimin që akumulohen çdo ditë e më tepër, në shpirtat me ndjeshmëri të thellë. Ata janë të vetëdijshëm se tranzicioni nuk është kohë për shfaqje talenti, nuk është kohë për art, përkundrazi, arti dhe shpirti krijues ngulfaten në periudha të tilla. Megjithatë, njëjtësimi me gjigantët e rok-ut, u shërben atyre si një bastun, për t'u mbajtur gjatë shtegimit nëpër erërat e stuhitë e kohës.

Krahas rok-ut, romani përshkohet edhe nga elemente të tjera simbolike si vdekja, shiu e ëndrra, që bartin kuptime më të thella kur shfaqen krahas peshës së rëndë të jetës. Përgjatë rrëfimit hasen situata ku vdekja ndjehet, por nuk shkakton ankth; pritjet, si rrugëtim i pashmangshëm; ftohet, si zgjidhje e vetme e mbetur, apo mendohet, si akt që përmbledh edhe bilancin jetësor. Thuhet se vdekja dhemb më shumë kur jeta nuk jetohet, por personazhet e romanit, të lodhur nga përjetimet, sprovat dhe dhembjet e jetës nuk i frikësohen asaj. Përkundrazi, ajo duket e vetmja pikë drite në fund të tunelit. Ndërsa shiu që e përshkon romanin fund e krye, fuqizon atmosferën e trishtë dhe monotone të kohës, ku njerëzit në vend se të jetojnë, duhet të mbijetojnë. Përpjekjet e tyre për mbijetesë shtresohen në sferat e thella të ndërdijes, ku gërshetohen me dëshirat e shtypura dhe sajojnë ëndrrat përplot makthe, makthe këto, që në fakt janë shëmbëllim i jetës së tyre.

Romani "Në Tiranë bie shi" është një pasqyrë e realitetit aktual, dëshmi e një kohe të pakohë, kronikë e një epoke ku edhe karakteret më të forta shndërrohen në genie amorfe, ku pamundësia është tipari kryesor i 'heronjve bashkëkohorë'. Me këtë roman, Kliton Nesturi e pasuron korpusin e veprave letrare që përjetësojnë dhimbjen, sakrificat, përjetimet dhe rezistencën e intelektualëve shqiptarë gjatë periudhës së stërzgatur të tranzicionit.

Profil: Xhevahir Spahiu

POETI I NGJYRAVE, FLUTURIMIT DHE I HAPËSIRAVE

Poeti është vëzhgues i hollë i jetës së fëmijëve, njohës i mirë i psikologjisë së tyre. Ndaj dhe momentet poetike Xhevahiri i gdhend me mjeshtri



Xhahid BUSHATI

Poeti i shquar Xhevahir Spahiu, si vetë emri që e identifikon 'xhevahir', i tillë është në panteonin poetik të letrave shqipe, po i tillë është edhe në letërsinë për fëmijë e të rinj, me librat poetikë që ka botuar, si: "Ti, qytet i dashur..." (1973), "Zambakët e Marnicës" (1981), "Ekran i kaltër" (1982), "Kitaristët e vegjël" (1987), "Kryeartëzat" (1988), "Dielli i lodrave" (1990). Poezitë më të mira e më të bukura të këtyre vëllimeve poetike janë përmbledhur në librin "Zogj të kaltër" (Shtëpia Botuese "Mësonjëtorja e Parë", Tiranë, 1999).

Krijues i talentuar që i ka mbetur besnik poezisë!.. Si poeti Xhevahir Beqaraj. Këtu, tek poezia, duhet ta kërkojmë: origjinalitetin, perceptimin poetik, tiparet, etj., të krijimtarisë letrare të Xhevahirit. Këtu, te poezia, ku nuk gabojmë po të themi se është "vendlindja" e tij. Sepse nga kjo "Vendlindje", erdhën këto libra, që u botuan brenda një periudhe 17 vjeçare. Duke i shfletuar, njihemi me plot motive jetësore, interesante dhe të perceptuara me syrin e poetit e të fëmijës-lexues. Brenda asaj bote libri 'gëlojnë' hapësirat përrallore me fantazi të besueshme e të pabesueshme, me rrjedhat e burimit, lumit e të detit që e ndjekin njeriun në udhëtim, që i shfaqen në gjurmë dhe në zemër i buçasin. Brenda asaj bote libri ndrit dielli i shtëpisë si një dashuri e madhe, me lodrat e ëndrrat për to, me abetaren që rri në krye, me fjalën magjike: Të lumtë dora! me dritaren në kohë; me zërat e fëmijërisë e të kujtimeve; me gjurmët në jetë e në muze, me fluturime të kaltra e fluturime shqiponjash... Kjo është dhe arsyeja që Xhevahir Spahiu, duke qenë poet i hapësirës, shprehet kështu: "Dëgjomëni mua: ju duhet të mbetenit fëmijë sa më gjatë. Pa shihmëni në sy: herë-herë jam fëmijë e shkuar fëmijës. Mburrem me këtë. ... Po të mos u zija pusi fëmijëve të mi, juve, vetes sime, t'i merrja bukuritë e shpirtit fëmijëror, ato do të humbisnin sikur të mos kishin qenë kurrë dhe një mjerim i madh, i pasosur do ta mbulononte këtë botë!... Kam vetëm një

kërkesë: mbaroni njëherë librin së lexuari dhe, pastaj, të drejtën e autorit le ta mbrojë botërisht një trup gjykues i përbërë nga: një shqiponjë, një kalë dhe një lis."

E, duke marrë shkas nga parathënia, e cila është konceptuar e tëra si një polifoni tingëllimash e ritmikash të larme poezie e vibrim kohor, është e pamundur të mos vësh re rrefimin e singertë të poetit si në poezitë e tij, komunikimin dhe marrëdhëniet me lexuesin-fëmijë si në poezitë e tij, shprehësinë emocionale, figuracionin e pasur artistik e spontanitetin si në poezitë e tij. Malli për fëmijërinë e tij, malli për zemrën e lexuesit të vogël, si dhe malli i zemrës së lexuesit të vogël për zemrën plot motive pafund e të befta të poetit, që depërton aq bukur në botën shpirtërore të fëmijës; mbetet i pasuar dhe me një dritë kujtimesh, që, vërtet të merr malli.

Të mos harrojmë se, Xhevahir Spahiu vjen nga letërsia për të rritur. Në dimensionet e saj, ai ka shfaqur dinjitetshëm portretin e tij poetik. I ngjan një guri të çmuar. Për vlerat dhe kontributin e shfaqura, me të drejtë një studiues thotë: 'Xhevahir Spahiu është ndër zërat më të spikatur dhe më autentikë të poezisë bashkëkohore shqiptare'.

Në këtë periudhë të mirëseardhjes në letërsinë për fëmijë e të rinj, ai pasuron më tej larminë e individualiteteve poetike që besnikërisht shkruajnë për fëmijë dhe i janë kushtuar asaj, siç ishin: O. K. Grillo, Xh. Beqaraj, A. Mamaqi, T. Gjakutaj, B. Harxhi. Ndërsa poezisë për fëmijë të tri niveleve i jep frymëmarrje më të gjerë, veçanërisht me trajtimin e temave të njerëzores, të vlerësimit të dinjitetit, humanizmit, qytetarisë dhe socialitetit, etj; të cilat realisht i mungonin kësaj letërsie. Ardhja e Spahiut nga letërsia për të rritur në letërsinë për fëmijë, është e njëlojtë edhe me ardhjen e poetëve, si: Moikom Zeqo, Llambro Ruci e më vonë Anton Papeleka, e më vonë Pandeli Koçi (Sazan Goliku). Te Moikom: krahas fabulave, legjendave, gojëdhënave, përrallave (shpesh edhe në prozë), motivi i detit merr përparësi, bëhet metaforë e krijim-

tarisë së tij. Te Llambroja: zëri i historisë është i pasuar, meloditë e pavdekshme të Jugut 'strehohen' natyrshëm e plot finese në vargjet e poezive, aftësia komunikuese mbart emocion dhe ngjyrë. Te Anton Papeleka (prozë: legjenda, përralla e tregime dhe poezi) kujtesa historike për të mos e humbur vjen si një muze i gjallë, motivet poetike ruajnë pastërtinë dhe freskinë e bëshkëve duke i trajtuar me një këndvështrim origjinal. Te Pandeli Koçi (Sazan Goliku): (prozë: përralla, legjenda e tregime dhe poezi), gjejmë besnikërinë ndaj fabulës, spektrin ngjyror të fjalës dhe zhërvjellësinë në ecurinë e veprimeve të personazheve.

Në këto 17 vjet të krijimtarisë poetike për fëmijë e të rinj, është e pamundur gjatë leximit e rileximit të poezive të xhevahirit të Xhevahirit, të mos ndalesh në disa tipare, të cilat janë fjalë-çelësa për të njohur dhe shijuar këto krijime.

-Edhe kur motivi është i njohur, Spahiu do ta konceptojë artistikisht dukurinë nga një kënd tjetër vështrimi, duke i mëshuar gjetjeve të reja, figurave origjinale, të thjeshta e të këndshme dhe në fund... një rrefim i singertë fëmijëror: "Babi, babi, thuaji zogut: / "Zbrit një çikë, o yll!" / të këndojë në dorën time, / siç këndon në pyll. // Do ta puth në të dy faqet, / t'i them: - Fluturo! / Në mëngjes tek xhami, eja, / tak-tak-tak! Më zgjo..."

-Poeti është vëzhgues i hollë i jetës së fëmijëve, njohës i mirë i psikologjisë së tyre. Ndaj dhe momentet poetike Xhevahiri i gdhend me mjeshtri: "Një ditë shkon. Pas saj vjen tjetra, / ti mbjell një pemë, një gur t'i vë; / nga guri, ja, u ngrit ndërtesa, / dhe pema pyll i madh u bë! // Koha vrapon. Vrapon si lumë; / nga kalendari fleta ra. / vetvetes pyetjen i bëj unë: "Ditës ç'i dhe e çfarë të dha?"

-Figuracioni është me shumë fantazi dhe merret po nga bota femi-nore. Flladi lirik si një puhizë e ëmbël 'shëtit' në të gjitha gërmat e fjalët e poezisë, dhe më në fund 'troket' ëmbël në 'portën' e zemrës së lexuesit të vogël. Dhe ja se si: "Udha vetëm nuk kalohet, / udha shokun e kërkon; / është e gjatë - zvogëlohet, / është e rëndë - më pak rëndon. // Dora dorës i fal brigje, / fjala fjalës i jep zjarr, / Kur është vetëm nëpër shtigje / mban një shkop çdo udhëtar.

-Çdo fjalë në poezitë e Spahiut është e qëndisur me kujdes. E në këtë qëndisje nuk mungojnë që plot poezi mbyllen gjithmonë me një kurorë të bukur, me një gjetje të papritur, ku lexuesi krahas mahnitjes buzëqesh si vetë moshë. Mes shumë poezive zgjedhëm atë me titull: Dy shqiponja. Poeti rrëfen: "Dy shqiponja atje lart / çajnë qiellin e pamatë. // Njëra erdhi që nga malet, / ec e ec e s'di të ndalet. // Tjetra ngritur majë brigjeve / nga hareja e fëmijëve. // Njëra krahët rreh paprerë, / ulet ngrihet, s'pyet për erë. // Tjetra është

një shqiponjë, / vizatuar në balonë. // Djemtë e lagjes, ëndërrtarë, / me balona qiellin çajnë. // Dy shqiponja fluturojnë, / një e gjallë e një balonë.

Librat poetikë të Spahiut, të para në optikën studimore, janë letërsi e botës së madhe të fëmijëve, të cilët janë pafundësisht kureshtarë dhe pyesin pafundësisht... Shfletoni këto libra dhe mendimet e mësipërme do t'i gjeni të pasqyruara në shumë poezi, të cilat, siç thotë poeti janë 'dritare në kohë'. Një bashkëbisedim me të, ti, lexues i dashur i çdo moshe, do të përpiqesh të njohësh dhe të përjetosh një botë të qytetëruar... Por... do të kuptosh se edhe në ç'pozicion je ti... Dhe kjo është arsyeja pse duhet të investohet për këtë letërsi... Një botë që duhet njohur!..

Xhevahir Spahiu është një poet lirik. Si i tillë, peneli i ngjyrës, veçanërisht: të kaltrës është i pranishëm dhe metafora e saj flet dhe ka domethënie e saj... ndoshta... të fal qetësi e qartësi, ngjyrën e qiellit e të detit, të zogut e të malit, tendencat e një harmonie. Ndoshta... të fal akoma një fjalë të pathënë të autorit; eh, sa të fal!.. Poeti si një bashkëbisedues i mirë na lë të kuptojmë se përmes kësaj ngjyre, ai njeh mirë psikikën dhe interesat e fëmijëve.


Studiuesi Ilija Lëngu, duke folur për alkiminë e fjalës së Spahiut, në mes të tjerave, thotë: "... i jep në mënyrë të vetëdijshme fjalës poetike më tepër liri e pavarësi, në kuptimin që ai i bashkon e i lidh fjalët mes tyre gjithmonë e më tepër sipas konceptit modern të dashurisë së lirë, të aventurës së fjalës, ku takimet e papritura, efekti i befasisë ka pjesën e vet në aktin apo "çastin hyjnor të krijimit". Për të zbuluar sadopak këtë tharm poetik, po përmend shumë fjalë-shenja që më kanë shoqëruar gjatë leximit dhe studimit të poezive të poetit, si: mëngjesi, stinët, qielli, dielli, hëna, yjet, lumi, deti, mali, shiu...; zogu, foleja, plepi, kavakët, bleta, lulishtari, lulet...; vendlindja, fëmijëria, lodrat, malli, kujtimet, ora, guaska e detit, nëna, babai, gjyshi, gjyshja, motra, vëllai...; shqiponja, luleshqiponjat, balonat, furtuna, kuajt, udhëtimi, mësuesi, Gjuha shqipe...

Duke njohur poezinë e Xhevahir Spahiut, nuk ruajmë të njëjtin mendim, me ndonjë kritik, i cili vite më parë ka shkruar kështu: "... për një kujdes më të madh në vargëzim", si dhe "për të shmangur ndonjë konceptim ideoartistik të patretshëm prej fëmijëve". Mjafton të themi, se në këto krijime poetike ruhen si relikte të shenjta: vazhdimësia logjike e mendimit, natyrshmëria e rrefimit, qëmtimi befasesues i detajeve poetike, për çdo poezi synon të gjej një fabul, sado të vogël rreth së cilës organizon tërë poezinë, por ndodh shpesh që vetë detaji poetik luan rolin e një fabule në miniaturë; gjetja interesante, aftësia për të depërtuar në botën shpirtërore të fëmijës.

Shkodër, janar, 2023

BARDI SKOCEZ

Bërnsi ishte fshatari më i thjeshtë i fshatit më të thjeshtë të Skocisë. Dy gjëra nuk shkundi dot sa jetoi nga vetvetja, vjershat dhe borxhet



Grigor JOVANI

Është mbase rast i rrallë në botë kur festa kombëtare e një vendi sfumohet nga një tjetër, jo zyrtare. Për Skocinë e kam fjalën, ku ky komb krenar "malësorësh" të paepur, tjetër "ditë kombëtare" ka shënuar në kalendar, Ditën e Shën Andreas, dhe tjetër i krenojnë bashkëkombësit. Çdo vit, më 25 janar, kur është ditëlindja e poetit kombëtar Robert Bërns, e gjithë Skocia feston "Burns Night" - "Natën e Bërnsit". I rrallë ky fakt, por më e rrallë akoma është lidhja që ka ky komb me një poet. Lidhja e tij legjendare me Skocinë, përkushtimi që i fali kombit që e lindi dhe të cilit i këndoi gjithë jetën, ngjashmëria e tij perfekte me bukurinë dhe tiparet më të qenësishme të ADN-së së një populli janë të papërsëritshme. "Rabbie Burns", siç e njohin dhe e përfolin skocezët, është njeriu që shikon në pasqyrë më i thjeshti fshatar prej tyre, ai vetë. Një legjendë më vete.

KUSH ËSHTË ROBERT BERNISI?

Erdhi në jetë më 1759, si biri më i madh i një familjeje fshatarësh, ku prisnin të hanin shtatë fëmijë. I ati kishte niqasur një tokë në fshatin Alloway dhe duhej puna e të gjithëve që elbi i mbjellë në të të mjaftonte për kaq gojë të uritura. Biri i madh, "Rabbie" nuk ia përtonte punës. Nuk njihje dhe mënyrë tjetër jetese. Përveç vjershave, sigurisht. Atje gjente kënaqësinë e jetës. Shkruante sikur këndonin instrumentistët popullorë rrugëve dhe mejhaneve, ku birra derdhej si përrenjtë nga malet dhe gratë zbulonin nëpër valle gjinjtë e bëshëm, si arat e begata. Gjatë 37 vjetëve të jetës së tij të shkurtër, krijoi mbi 700 vjersha. Ajo që i shpëtoi dhe jo për faj të tij ishte një vjershë për të birin, Maksuelin, i cili erdhi në jetë pikërisht ditën që përcillej në përjetësi i ati. Bërnsi ishte fshatari më i thjeshtë i fshatit më të thjeshtë të Skocisë. Dy gjëra nuk shkundi dot sa jetoi nga vetvetja, vjershat dhe borxhet. Të parat e lumturonin, të dytat e trishtonin. Gjeti një zgjidhje të zakonshme për të shpëtuar nga halli i përditshëm i borxheve, birrën skoceze. Siç bënin xhanëm gjithë të varfrit që njihje. I simpatizonte shumë njerëzit e thjeshtë, e plagoste thellë në shpirt

padrejtësia shoqërore ndaj tyre. Ndjeshe skocezi më i ndëshkuar nga fati, por edhe më i privilegjuari, dinte të këndonte për njerëzit si ai vetë, mund të shprehte me vjershat që shkruante atë shpirt, më mirë se askush tjetër. Tema e preferuar ishte hendeku i thellë midis të varfërve dhe të pasurve. Nuk harronte kurrë të nënvizonte në artin që krijonte se shpirti i të varfërve ishte aq i pasur në ndjenja, sa kuleta e të pasurve me monedha. Vetë preferonte shpirtin e lirë, gratë e bëshme të valleve dhe uiskin e mrekullueshme të kokrrave të elbit. Mbahet mend si pijedashës i famshëm, cilësi që i ofroi fundin e shpejtë. E tradh-toi zemra, e kishte lodhur kaq shumë me këngët e tij të pambaruara. Por jetoi siç dëshironte, këngëtar i lirë, i pasionuar me dashurinë dhe gjithçka tjetër simbolizonte vendin e vetë. Në fund të fundit, ç'është një skocez? Malet e lira dhe feja e tij, dashuria, vallet dhe uiski. Pasaporta e tij prej skocezi ndihet tek e gjithë vepra që shkroi. Gjuha që flasin këta njerëz gjeti perfeksionimin më të madh tek ky art, që Bërnsi u la trashëgim.

"Burns Night" - TRADITA QE U BE FESTE KOMBETARE

I pari kremtim i tillë u regjistrua para dy shekujve, më 21 korrik 1801, në Ayrshire të Skocisë, gjatë një darke përkujtimore nëntë miqsh të ngushtë të poetit, i cili ishte ndarë para pesë vitesh prej tyre. Kjo darkë përmbante menynë e zakonshme të kuzhinës së skocezëve të thjeshtë, pjata tradicionale me mishra "haggis", si edhe koka e zierë e një deleje në mes të tavolinës, ku birra dhe uiski tepronte. E para u deklamua vjersha e famshme e Bërnsit "Address to a Haggis", të cilën e dinë përmendësh gjithë skocezët. Pastaj vërshuan këngët e vjershave të tij të melodizuara. Doemos, si në të gjitha kremtimet e tilla të mëvonshme, Robert Bërnsi ishte prezent. Duke u kthyer tek darka e parë, fillimisht u gabua me datën e lindjes, gjatë fjalëve përkujtuase. Përmendnin 29 janarin e vitit 1802, por ca kohë më vonë u zbuluan arshivat e fshëhura të kishës krahinore në Ayr, që dëshmonin se dita e saktë e lindjes së Robert Bërnsit ishte 25 janari i vitit 1759. Nga dita e këtij zbulimi e mandej, gjer në kohët tona, "Burns Night" festohet çdo 25 janar, datë që prej kohësh shënon "festën kombëtare" të të gjithë skocezëve, kudo që ndodhen. Aq i "zakonshëm" u duket ky "sakrilegj kombëtar", lënia në shkallë të dytë e festës kombëtare zyrtare të Shën Andreas, sa Parlamenti skocez zyrtarisht njohu festimet e "Burns Night" si elementin më të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në vend. Natyrisht, nuk mund të përgënjeshtrojnë vetveten. Parlamenti skocez konsideron këtë bard popullor si poetin më të madh që ka nxjerrë historia e vendit, vepra e të cilit ishte guri më i rëndë në murin që mbrojti gjuhën e tyre të lashtë përballë stuhive të shekujve. Këto festime në nder të tij nuk janë gjë tjetër veçse ripërtëritja e ndjeshmërisë kombëtare.

Dan Fante

MIKU

Ne jemi miq
ne flasim në telefon disa herë në javë
për gra dhe vëllain e tij narkoman
e shoh atë në takimet e AA
dhe ngandonjëherë ai vjen te unë
dhe ulet në tryezën time në kuzhinë dhe pi kafen time
dhe rregullisht ma bën me dije se sa keq po i bëj vetes me pirjen e purove
dhe ngrihet dhe e hap dritaren time të hamamit pa më pyetur - aspak
dhe
një ditë zuri të më pyes rreth shkrimit tim
rreth romaneve të mia dhe rreth
kësaj drame apo asaj drame
dhe
sa herë më është dashur të rishkruaj librin tim të parë
dhe sa botuesve ua kam dërguar
dhe sa paguajnë ata
dhe
një
ditë
ai ma dha një tregim - pesëdhjetë faqesh - hapësirë njëshe
kërkonte t'ia lexoj dhe t'ia them mendimin tim
sepse ai gjithmonë donte të bëhej shkrimtar
kështu që e lexova dhe i thashë - dëgjo
- Don, ta zëmë prej njëshiti deri në dhjetë ky tregim
meriton notën gjashtë, por ti mos u ndal - sall vazhdo
Hustler Magazine nuk u ndërtua për një ditë
dhe
Doni shkoi në shtëpi dhe më thirri pas një ore
i tërbuar
për të thënë se çfarë karuci i pandjeshëm jam
dhe
pasi e përfunduam bisedën pushë macen time laramane të trashë
e cila është e përkushtuar njëqind për qind ndaj meje
deri sa e përkëdhel kur ajo kërkon një gjë të tillë dhe e ushqej
bash në kohën e duhur
dhe e falënderoj Jezu Krishtin
se si ndjehem vjen nga unë - një qendër e qartë -
nga zjarri që e kam ndezur vetë - përmes dhimbjes sime

NUK KISHA ASGJË PËR TË HUMBUR

Kur në moshën 44 vjeçare
fillova të shkruaj seriozisht
nuk pata pirë alkool nja tri vjet
dhe më në fund mund të rrija i vetëm në dhomë pa tentuar vetëvrasje

I dhashë vetes një qëllim - një faqe në ditë
kthehesha në strofullin tim në shtëpinë e nënës sime
nga takimet e AA të mesditës
dhe shkruaja atë faqen time

të mirë, të keqe apo indiferente

njashtu filloi e gjitha
një faqe në ditë
krejt çfarë bartte emri im ishte tërbimi
dhe makina e shkrimit e vjetër portative tekanoze Smith-Corona
e babait tim

asgjë tjetër - nuk kisha asgjë për të humbur
nuk kisha banesë
nuk kisha perspektivë për të gjetur punë
një automobil të mutsiantë të përdorur që ndizej në shtatë cilindra
pesëdhjetë dollarë në javë që m'i jepte Nëna si lëmoshë
dhe
imagjinatën time
dhe
një dëshirë - të bëhesha shkrimtar i mirë

tash - njëmbëdhjetë vjet më vonë -
askush nuk mund të ma mbyllë gojën

Përktheu: Fadil Bajraj

ELEGANCË E SHPREHJES

Në shumë nga poezitë e tij realiteti dhe e kundërta e tij gjejnë gjithmonë shkaqe për t'u ndeshur dhe kundërshtuar njëri-tjetrin. E pakryera tenton të bëhet e kryer, ndërsa e sotmja të bëhet e nesërme më e përkryer. Kjo e ka bërë poezinë e tij më të menduar dhe me ëndërrimtare njëherësh

Agim BAJRAMI

Ka poetë që edhe pse operojnë ne terrene të "njohur" të poezisë bashkëkohore, arrijnë të krijojnë para lexuesit një klimë dhe realitete të reja leximi. E them pa mëdyshje se Bledi Ylli është njëri prej tyre; i zhurmsëm mes zhurmës, i heshtur mes heshtjes, por ndërkaq një receptor i jashtëzakonshëm i zërave të bashkëkohësisë dhe ndjesive njerëzore. Duke jetuar në një vend ku perënditë dhe njerëzit jetojnë së bashku, poezia e tij e ka të pamundur të mos prekë dhe të mos preket prej tyre. Kam vite që e ndjek ecurinë poetike të këtij poeti dhe ajo çka më mbetet në mend nga gjithçka shkruan ai, është lirika e tij e ndërë dhe aftësia e tij e kultivuar për të depërtuar sa më tepër në substancialitetin e objektit poetik. Duke cituar titullin e një poezie të Ricos "Kuptimi i thjeshtësisë", kam përshtypjen se shumë nga poezitë e tij ngjizen dhe frymëzohen pikërisht nga ky kuptim. Autorit si mbetet veçse t'i nxjerr ata nga vendet ku ndodhen, duke ju dhënë ndërkaq edhe diçka nga fryma e tij. Subjektet e poezive të tij janë sa të thjeshtë aq dhe të ndërlikuar, sa të ndriçuar po aq dhe gri. Kjo ndodh se autori rrëmben nga përditshmëria ato çfarë e ngacmojnë dhe duken që së largu se janë të ngarkuar me lëndë jetësore dhe me eksplozivin e duhur shpërthyes. Ndaj nuk duhet të na bëjë përshtypje nëse në faqet e librit të tij do të gjeni pranë e pranë dy poezi me subjekte dhe ngjyra krejt të ndryshme. Një takim dhe një ndarje, një dashuri që po lind dhe një rekuem. Ajo çka evidentohet në krijimtarinë e këtij autori është teksti i ngjeshur me mesazhe dhe ide, si dhe pamjet grafike që i shoqërojnë ato. Ajri që rrethon poezitë e tij ka gjithmonë diçka nga natyra dhe karakteri i tij impulsiv, diçka nga mbrëmjet e nderura të Athinës dhe Mangalemit, por edhe nga dhimbjet therëse për imazhin e nënës në ikje. Në kufijtë ndarës të gjendjeve të tij shpirtërore, autori vendos gjithmonë një kontrast ngjyrash të theksuara. E bardha, e zeza dhe grija e qiellit në dimër. Edhe pse në numër të kufizuar, ato përsëri janë të afta për të realizuar kontrastet e synuar nga autori.

Kështu ndodh në poezitë "Dikur për ty", "Njëmijë ëndrra", "Shpirt i bukur". "Vetëm lind", "Kohë e humbur" e shumë e shumë të tjera. Në fakt më tepër se poezi, ato janë refleksione ndjesish njerëzore të derdhura në art në trajtë statujash poetike, që bëjnë

lëvizje të befta sa mes pasqyrave të ndryshkura të natës, aq edhe përballë pasqyrave të praruara të ditës. Nuk e teproj po të them se lirika të tilla kanë konfiguracionet e padukshme të erës, por që të shkaktojnë në trup dridhje të ëmbla...

Më vjen të nxjerr ty nga çdo varg
Të lë diku nëpër kujtime
Por ti ndriçon më shumë nga larg
Dhe bëhesh diell për muzën time.

E matur dhe shumë koncize e

formë sentencash të mbeten në mendje sa për peshën e pohimeve të tyre aq dhe për shkallën e lartë artistike të artikulimit. Është një poezi që matet dhjetë herë përpara se të flasë dhe kjo është shenjë pjekurie e autorit.

Në biseda me lexues të poezisë, kam dëgjuar shpesh herë përshtypjet se poezia e Bledit po i kthen poezisë emrin e mirë që ka pasur, duke të zgjuar njëherësh edhe dëshirën e humbur të leximit. Në faqet e portave të ndryshëm ka shumë krijues që


vetëm pak rreshta, si për të përshkruar një dramë të brendshme sentimentale, ashtu edhe një dramë më të madhe, siç është ajo e shoqërisë së konsumit, që e ka humbur me kohë frymën e saj humane...

Jetë e bukur zemër madhe
Realitet edhe përrallë
Miq sa shumë kur je në valle
E sa "hiç", kur je në hall
Ti më pe të shtrirë përtokë
Dorën ule, por pe orën
Unë të dija mik për kokë
Thashë, për mua e zgjati dorën.

Në këtë poezi dhe të tjera, narrativa e heroit lirik ndërthurur ngushtë me alegorinë e autorit shërben jo vetëm për të ndriçuar pjesë të poetikës së tij individuale, por edhe për nënvizimin e shpirtit demoniak të një shoqërie të dehumanizuar dhe të zhveshur nga gjithçka të mirë. Në poezitë e dashurisë alternimi i frymës lirike me simbolin i ka dhënë vargut të tij fuqi, edhe identitet artistik, larg klisheve dhe trajtimeve të zakonshme letrareske.

Thashë të shkruaj për sytë e tu
Nga partitura të fundin akt
Asgjë nuk pipëtin këtu
Unë përballë muzgut të flaktë.
Janë disa orë kaq monotone
Sa përmbi letër prehet një muzë
Sytë i vijnë rrotull kësaj dhome
Shpirt jep lapsi aty mbi buzë.

Vini re se me sa efikasitet i përdor autori elementet destruktiv, për ta bërë sa më të vërtetë çastin e tij të errët të vetmisë dhe dramës individuale. Mungesa e pipëtimës, orët monotone, lapsi që jep shpirt mbi buzë etj, janë kaq të gjetur dhe origjinale. Bledi Ylli të bën përshtypje për entuziazmin që e derdh me bollëk nëpër vargje, për elegancën e shprehjes, por edhe për trillet e tij të panumërta poetike. Shumësia e motiveve dhe thellësia e trajtimit origjinal të tyre, e ngrenë poezinë e tij tashmë në maja përherë e më të larta. Jo më kot librat e tij lexohen me një frymë dhe numri i tyre vazhdon të shtohet çdo ditë e më shumë. Duke kundruar marrëdhëniet e ngushta mes poetit dhe poezisë, unë e kam të vështirë të përcaktoj se kush prej tyre e do dhe adhuron më shumë njëri-tjetrin, poeti apo poezia. Sidoqoftë ata vazhdojnë të ecin vazhdimisht krahe njëri tjetrit dhe nuk kanë ndërmend ta lënë në mes këtë udhëtim.




brendshmja e kësaj poezie duket se buron nga maturia e divaneve filozofikë të mendimtarëve të njohur beratas, por edhe nga inteligjenca dhe kultura e filozofisë bashkëkohore të poetit. Mpleksja dhe harmonizimi i të dyja kulturave ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë për mirë. Autori e ka shpallur me kohë kredon e tij intelektuale dhe nuk ngurron ta shpërfaq me çdo kordë zanore. Në këtë kontekst në shumë nga poezitë e tij realiteti dhe e kundërta e tij gjejnë gjithmonë shkaqe për t'u ndeshur dhe kundërshtuar njëri-tjetrin. E pakryera tenton të bëhet e kryer, ndërsa e sotmja të bëhet e nesërme më e përkryer. Kjo e ka bërë poezinë e tij më të menduar dhe me ëndërrimtare njëherësh. Edhe poezitë e shkruara në

kërkojnë të evidentohen si protagonistë, duke publikuar herë pas here krijime të zbehta dhe të parealizuara. Ndryshe nga ta, krijimet e Bledit karakterizohen nga subjektet e zgjedhur dhe një narracion tërheqës jetësor, narracion që më shumë se pasqyrim është në vetvete një refleksion dhe interpretim përditësije. Gjithmonë me një shumëllojshmëri mjeteshe dhe thellësi të admirueshme psikologjike ai tashmë ka krijuar një identitet më vete. Duke qenë e identifikuar në kohë dhe hapësirë edhe lineariteti i rrëfimit dhe pasqyrimin të saj vetvetiu pëson përthyerje dhe zhvendosje të herë pas hershme. Autori i shmanget me sa mundet proliksitetit të fjalës dhe përshkrimet e panevojshme. Atij i mjaftojnë

POEZIA E BEQIR MUSLIUT

Arsenali i tij poetik përbëhet nga një varg figurash, simbolesh, formulash, toposesh dhe mjeteshtjera gjuhësore-stilistike, të huajtura nga folklori, mitologjia dhe historia kombëtare ose e krijuar në mënyrë të pavarur dhe individuale



Sherif SELIMI

Beqir Musliu është njëri nga poetët e letërsisë shqiptare, krijimtaria letrare e të cilit korrespondon me poetikën e simbolizmit evropian dhe është në përputhshmëri të plotë. B. Musliu është në të njëjtën vijë të krijimit me Edgard Alen Poen, Charl Bodlerin, Stefan Malarmen, Pol Verlenin, etj. Sipas tyre, përveç të bukurës, si kategori estetike ekziston edhe e shëmtuara, apo „bukuria e zezë“. Konceptet poetike të Musliut janë në të njëjtën vijë me ta, kur është fjala për aktin e krijimit. Edhe poezia e B. Musliut përputhet me dis-harmoninë, që vije si rezultat i tragjikes. Sipas Aleksandër Bllokut: „poezia më tepët „zbulohet“ se sa që shkruhet dhe pastaj bëhet medium, që ajo vetë e përcjell mesazhin, prej një paraforme të ekzistimit të saj“. Nëse ndalemi ta zbulojmë poezinë e Beqir Musliut, do të shohim se ajo do të bëhet

medium, që do ta përcjellë mesazhin përmes simboleve që i merr nga folklori, mitologjia dhe historia kombëtare ose të krijuara në mënyrë të pavarur-individuele, duke qenë në kontakt me kulturat tjera, që mund të trajtohen si paraforma të ekzistencës së saj.

„Nuk ka dyshim se B. Musliu është poeti me fantazi të pasur dhe kërkuesi të gjerë krijuese... Arsenali i tij poetik përbëhet nga një varg figurash, simbolesh, formulash, toposesh dhe mjeteshtjera gjuhësore-stilistike, të huajtura nga folklori, mitologjia dhe historia kombëtare ose e krijuar në mënyrë të pavarur dhe individuale (shumë herë edhe në kontakt me literaturën e lexuar). Mirëpo, derisa simbolet e marra nga folklori, mitologjia dhe historia kombëtare, çfarë janë Rozafa, Gjergj Elez Alija, Albanopolo, Dardania, Kulla, etj., apo edhe nga mitologjia antike e orientale (Fenik-

si, Promoteu, Sizifi, Szamet etj.), rrezatojnë kuptime pak a shumë të afërta dhe të kapshme për lexuesin, simbolet e ashtu quajtura private, individuale, ... (p. sh., bukuria e zezë, fyelli i humbur, trëndafilat e drujtë, lumi që ka aromë trëndafilat, druri i zi, etj.)“.

Poezia e Beqir Musliut, përveç se e njeh poetikën e simbolizmit, ajo e njeh edhe poetikën e surrealizmit dhe hermetizmit. Kështu duket qartë se ai e kundërshton formën e krijimtarisë letrare të realizmit socialist, që zhvillohej asokohe në letërsinë shqiptare (në veçanti në Shqipëri, që ishte vënë në shërbim të politikës). Kështu, Beqir Musliu me poezinë e tij e kundërshton logjikën utilitariste (art për masën) dhe e sjell konceptin art për artistin.

Beqir Musliu e ka kuptuar se në letërsinë evropiane simbolizmi ishte formacioni i parë stilistiko-letrar që e ka mohuar realizmin dhe natyralizmin, kurse kontinuitetin e kërkonte me një formacion tjetër stilistiko-letrar, pra me romantizmin,

duke iu kthyer individualizmit. Kështu, simbolistët e përjashtojnë utilitarizmin (art për masën), që ishte karakteristike për poetikën e realizmit dhe i kthehen lartpularizmit (art për art), që do të jetë karakteristike për të gjitha fraksionet e modernizmit dhe postmodernizmit. „Duke qenë poet me imagjinatë të pasur, por të padisiplinuar në masë të duhur, B. Musliu sjell një materie (lëndë) po ashtu të pasur poetike, por edhe të pasistemuar dhe të paseleksionuar sa duhet“. Agim Vinca kur thotë se poezia e B. Musliut është „e pasistemuar dhe e paseleksionuar sa duhet“, na bën të kuptojmë se është fjala për tekstin automatik, në artin figurativ e kemi pikturën automatike, bazuar në aspektin psikik si pjesë e funksionimit të nënvetëdijes, që nënkupton mbretërimin e lirisë, pra që është karakteristike për poetikën e surrealizmit.

„Arbitrariteti i shenjave dramatike

dhe teatrore, mungesa e një konsekuence artistike, është pasojë e tipit të shkrimit automatik, surreal-ist, asociativisht të pakontrolluar“. Sipas teorisë së Rolan Bartit, kemi vdekjen e autorit dhe lindjen e lexuesit. Kështu, përjashtohet autori dhe vihen relacionet midis tekstit-veprës dhe lexuesit. Pra, atëherë nuk është me rëndësi të merremi me autorin, por me poezinë e Beqir Musliut. Mund të themi se poezia e Beqir Musliut paraqet revoltën kundër realizmit, e në veçanti kundër realizmit socialist, madje poezia e tij e njeh poetikën e simbolizmit, poetikën e surrealizmit dhe poetikën e hermetizmit. Nga ana tjetër edhe sikur në mënyrë të pavetëdijshme t'i kishte krijuar këta forma të poezisë, sipas Zhak Lakanit edhe pavetëdija është gjuhë. Por, Beqir Musliu këtë e bën në mënyrë të vetëdijshme, poezia e tij korrespondon me poetikën e simbolizmit, surrealizmit dhe hermetizmit. Pra, meqenëse poezia tij i njeh këta forma, kjo është edhe një dëshmi shtesë që e përforcon bindjen e Nehas Sopajt, se me Beqir Musliun fillon postmodernizmi në letërsinë shqiptare. „Nga natyra e shkrimit, krahas mungesës së narracionit (që mund të na presupozonte titulli, pra baladë a legjendë), hartimi letrar që lexojmë këtu, pothuaj me asgjë nuk dallon nga hartimet tjera të pjesës së parë të librit, që s'janë veç „legjenda“ e „balada“, mandej këto hartime të pagëzuara si legjenda e balada edhe në dy librat e parë të autorit, po si edhe në të gjitha librat tjerë të mëpastajme, vazhdojnë të jenë problem i leximit të lexuesit si do ai t'i pagëzojë, vjersha apo poema, sepse ato janë poezi të pastra të mbindërtuara ashtu siç ndodh në artin post-modern“. (Nehas Sopaj Individualitete letrare i Beqir Musliu (studim) Shtëpia Botuese Rozafa, Prishtinë, 2008).

Simbolet e marra nga folklori, mitologjia dhe historia kombëtare, në poezinë e Beqir Musliut na dalin si balada e legjenda: Legjendat mbi vorret e krushqve, Gjergj Elez Alia ose Balada për balozin shtatë krerësh, Motra me nandë vllazën dhe përalla e përhimtë ose Balada për shtatë ditë e shtatë net, të cilat shërbejnë si forma intertekstuale. Intertekstualiteti në kuptimin e ngushtë të fjalës paraqet pjesët që gjejnë më pak ose më shumë vende konkrete të komunikimit me një tekst tjetër. Këtu baladat dhe legjendat kombëtare hyjnë në poezinë e B. Musliut dhe marrin dimension të ri. Kjo tregon se është fjala për paraqitjen e një dukurie të re në hapësirën e letërsisë shqiptare, konkretisht në poezinë e B. Musliut.

P.S. Poshtë shënimet për shkaqe teknike janë mënjantuan

FIGURA E SKËNDERBEUT NË DIMENSIONIN ESTETIK

Skulptura e Skënderbeut, është figurë simbol, është arketip që e vë në lëvizje procesin e rikrijimit në kohën e qenies kolektive, është formë simbolike që na kthen në origjinë



Afrim REXHEPI

Sipas teorisë fenomenologjike të Hartmanit, skulptura është shpirt i objektivizuar, është lidhja midis materies dhe shpirtit, është lidhja midis reales dhe joreales, është vet fenomeni estetik. Struktura e formës së përshkallëzuar përbëhet nga dy plane: plani i parë (Vordergrund) dhe plani i dytë (Hintergrund). Plan i parë (Vordergrund) është i jashtëm, është material, është real, mund të shihet dhe preket. P.sh. në poezi janë fjalët; në pikturë janë ngjyrat dhe drita; në skulpturë janë guri dhe bronza; në arkitekturë janë hapsira dhe masa; në muzikë janë koha dhe tingulli; në dramë janë gjestet dhe lëvizjet etj. Plan i dytë (Hintergrund) është plan metafizik, imagjinar, është joreal, nuk mund të shihet dhe preket, pra është shpirtëror. Plan i dytë është zonë metafizike ekzistenciale. P. sh. në poezi janë idetë dhe imazhet narrative; në skulpturë figurat dhe bota e tyre e brendshme; në muzikë shpirtërorja e formave; në dramë janë konfliktet dhe fatet e personazheve etj.

Për të qenë më të thellë dhe më sistematik në interpretimin estetik të figurës së Skënderbeut, objektet estetike skulptura Skënderbeu në Krujë nga Janaq Paço dhe poezia Portreti i Skënderbeut nga Ismail Kadare, do t'i analizojmë në bazë të konceptit estetik komparativ të estetit Etien Suriau. Estetika e tij, në thelb komparative, nuk merret vetëm me format e artit, por edhe me format

universale kozmike. Tendenca për kapjen e formës së pastër (gjë që nuk mundi ta realizojë pasi edhe format abstrakte nuk mundën pa përmbajtje) bëri përpjekje ta realizojë atë përmes katër planeve ekzistenciale:

- Ekzistenca fizike: nuk mund të bëhet skulptura pa material ndërtimor, gurë, bronz, apo nuk mund të bëhet poezia pa fjalën, shkrimin etj.

- Ekzistenca fenomenologjike: nuk mund të ketë vepër artistike, nëse akti i perceptimit nuk shkakton efekt estetik - nëse nuk funksionon estetika e kontaktit - relacioni objekt estetik - recipient. Nuk mund të ketë skulpturë që nuk mund të preket, nuk mund të ketë poezi që nuk mund të lexohet. Figura e Skënderbeut në skulpturën e Paços, është e vendosur në konturat tredimensionale, me proporcione të estetikës klasike. Shohim figurën e formësuar, të ngjirë, figura qëndron e qetë, nuk lëviz, nuk jeton. Në poezinë e Kadaresë lexojmë shkrimin diskursiv, të formësuar në katër katrena, me sistem të rimuar abcb.

- Ekzistenca figurë: materiali i shkrirë në bronz zbulon dhe evokon njëkohësisht figurën, shenjën apo qenien, apo loja me fjalë në poezi zbulon dhe evokon figurën diskursive. Relacioni estetik - perceptioni mundëson të shohim, të perceptojmë më thellë. Në skulpturë perceptojmë figurën në lëvizje, perceptojmë shpirtin e figurës, perceptojmë figurën në aksion, perceptojmë forcën, madhështinë dhe bukurinë e figurës së Skënderbeut. Vetëm forma e jashtme e aksionit është e fiksuar në

figurë. Skënderbeu qëndron mbi kalë i ngurtësuar, njëkohësisht perceptojmë dinamikën e jetës së tij. Relacioni estetik objekt estetik - recipient definon figurën koekzistencë të reales dhe joreales. Në poezinë Portreti i Skënderbeut nga Ismail Kadare, opozicionet semantike dielli - hëna, dita - nata definojnë Skënderbeun figurë oksimoron - koekzistencë e entiteteve të kundërta. "Një emër Gjergj kish si diellin, Tjetrin si Hënë Skënderbe". "Atë që bënte ditën Gjergji, plotësonte natën Skënderbeu". Sikur akti perceptiv mundëson konstatimin e Niçes, "bëhu gjithçka në atë që je. Ik nga gjithçka, por jo nga vetja, sepse në të është fillimi dhe mbarimi yt". "Të vetmen kish veç Shqipërinë". Të qenët në qenie - definon Martin Hajdeger.

- Ekzistenca transcendentale: përmbajtja e objektit estetik, ideja esenciale, kualiteti metafizik i saj. Ajo që intrigon në interpretimin psikanalitik të figurës së Skënderbeut në dimensionin estetik (objekti estetik), është dallimi midis teorisë psikanalitike të Sigmund Freud, e definuar si nënvetëdije subjektive dhe teorisë psikanalitike të Karl G. Jung, e definuar si nënvetëdije objektive. Dallimi qëndron në faktin "gjithçka është e nënvetëdijshme, njëkohësisht është e projektuar në realitetin fizik". Për dallim nga Sigmund Freud, i cili teorinë e tij psikanalitike e betonizoi brenda trupit a psikës, Karl G. Jung krijon metodën e amplifikimit, metodën që lidh format kulturore-historike, edhe atë ato

forma të cilat janë me qindra a mijëra vite larg nesh. Në kontekst, projektimi i fushave të shpirtit, nënkupton zbulimin e strukturave, siç është dominanta psikike ose arketipi. Sipas teorisë psikanalitike të Jungut, vepra artistike (në kontekstin tonë figura e Skënderbeut), është nënvetëdije kolektive, është arketip, është energji, është dinamizëm shpirtëror që entropion, duke na (ri)pozicionuar në kohë. Karl G. Jung besonte që njeriu mund të bëhet i plotë vetëm në harmoni me forcat e arketipeve. Simbolet dhe arketipet janë pjesë përbërëse e nënvetëdijes kolektive të subjektit dhe njeriu fillimisht i zbulon ato në ëndrrat e tij, pikvështrime të zbuluara, shumë funksionale në zhvillimin kognitiv të subjektit. Përmes zhvillimit të njohurive ku mundësohet që nënvetëdija objektive individuale të integrohet në nënvetëdijen objektive kolektive, subjekti ndërton personalitetin e tij të plotë. Pra arketipet janë forma simbolike që na (ri)pozicionojnë në realitetin fizik.

Sipas teorisë së arketipeve të Karl G. Jung, nënvetëdija kolektive është baza, është psika më e thellë e përbashkët për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohërat. Gjithnjë sipas Karl G. Jung, ekziston vetëdija e sistemuar apo zanafilla mitike e mendimit tonë që natyrshëm paraparin e që na nxit të mendojmë kolektivisht. Skulptura e Skënderbeut, është figurë simbol, është arketip që e vë në lëvizje procesin e rikrijimit në kohën e qenies kolektive, është formë simbolike që na kthen në origjinë.

LIRIZIMI NË POEZINË MODERNE

Majlinda RAMA

Lirika nuk është një konvencion i instrumentimit magjepsës të Orfeut. Ajo është një gjendje, një formë, një përmbajtje, një shprehje shumëplanëshe me një rezonancë të palimituar figurative, ku fjalët tejshtyhen përtej planit fjalorik dhe anës konotative. Qysh ku francezi Boder do të botonte "Spleen", poetika botërore do të njihet një tjetër diskurs, jo vetëm për faktin se Boder ishte emfatik në poezinë e tij, por edhe estetishtë vargu njohu një hop cilësor. Dhe poezia, aq më tepër ajo lirike, ka një shteg diapazonal që bëhet karakteriale jo vetëm për bardët e këtij lëvrimi, por për këdo që synon të lirikoje. Le të marrim ngasje ilustrative. Përmes titullit oksimoronik "Vdekje e ëmbël", poetizimi i Boderit vargon: "Aty në një copë cepëtira ku...trupit pa shpirt vdekur mes të vdekurish" sfilon torturat.

Shpesh është vënë re një tendencë e përdorimit të elementeve komparativ përsa i përket poezisë lirike në kohë, por kjo do të shërbente thjesht si indicie më tepër me vlera evidentuese të thata. Ka një paralele midis lirikës dhe perceptivitetit të konceptit "poezi". Shkëpusim një vlerësim të Lamartin, i cili të "Fati i poezisë", do të ciklojë: "Poezia është ndjenjë dhe ndijm, shpirt dhe materie; ajo është arsyeja që shprehëse e saj është gjuha e përsosur, gjuha shkëlqimtare, që e pushton njeriun tërësisht dhe plotësisht, është ide që përshkon tejmbanë qenien njerëzore, është ndjenjë e shprehur përmes shpirtit, është figurë e selitur në imagjinatën e njeriut, është muzikë që të lehtëson veshin".

Assesi nuk duhet perceptuar skrupulliteti me termin "lirikë". Poezia ka kodin e vet komunikues me lexuesin, herë lehtësisht i dallueshëm dhe herë - herë pakëz i vështirë, por gjithsesi ekzistues. Një poezi flet jo vetëm përmes fjalës, por edhe efekteve tingullore dhe ritmike, duke krijuar kështu një ndjesi mbresëlënëse si në të lexuar, ashtu dhe në të dëgjuar. Tingulli, fjala, imazhi krijojnë trielen e ngjizjes së vargut, duke komponuar sinkretizëm dhe duke i dhënë poezisë formësimin e duhur. Mendimi poetik ka një shtrirje komode përmes rrjedhës logjike të ligjëritimit dhe, për anën e shprehësisë, shërben figuracioni letrar që kompletion tharmin poetik. Heroi i poetit lirik është në lëvizje, jo gjithherë një hero i tipizuar në konkrete, por edhe në abstraktizëm, mbishfaqur e nënshfaqur në trajtëza të ndryshme: një flijë bari, një gjethe e biskuar në sythin e parë të pranverës, lumi që dredhon zallishtës, kërkërimat e degëve të rrapit të qëmoçëm, teli i këputur i kitarës apo një mace e përhitur në shkallëparën e pragshkullit...Gjithashtu, është rasti i volitshëm të kujtojmë se "...poezia është magji që, për një çast, dhe pas një fjale të vetme, bën të shfaqet në botë", - siç do të shprehë Gjyo në veprën e tij "Arti në këndshikimin sociologjik".

Poetët lirikë modern na shfaqen si gjenerata më e gjallë, më shprehëse, më emocionale. Tingulli që zbrit prej këtij vargu, është i mbrujtur me një frymë e cila depërton përmes natyrës dhe mendimit të kristaltë. Vargu i kësaj rryme ka një mendim asocia-

tiv, ku mrekullitë shprehen në fare pak fjalë. Poezia lirike moderne shestohet si e tillë, kulmatike. Ajo ka një trend drejt lidhjes së anës grafike me atë të shprehësisë, duke u përpjekur që mesazhi të impostohet qoftë dhe me anë të vlerësimit vizual. Por, lirika moderne e tejshtyn dhe zgjeron këtë nocion, përtej stadi konservativ. Ajo i jep mundësinë lexuesit që të marrë detajet e mjaftueshme dhe, pastaj, të jetë vetë ai, lexuesi pra, që, sipas imagjinatës së vet, të ndërtojë në mënyrë eksklamative ose jo, botën e pafundme lirike realo - fiction.

Më mendje-vjen këtu vargu i poetit amerikan Wallace Stevens: "Bota juaj jeni ju. Unë jam në botën time" - Kjo nuk duhet parë vetëm si klithmë e filozofisë së papajueshmërisë, por edhe si një koncept kufijsh vizional. Nuk është as përplasje në bazë numrash ("JU" - "UNË"), nuk ka as "ju" të politesës (secila veç e veç e të gjitha së bashku), por poeti përdor ndarjen e "botëve", duke dashur të mbrojë hierarkinë "Bota ime", pa "...diellin që duket si kënetë e zezë" të një bote tjetër. Në "rravgimin" lirik të poezisë së Marianne Moore, nuk ka sesi t'i përvidhesh vargut: "Deti është një koleksionist" apo togut emërues të epitetit metaforik "sy grabitqar", të shprehësitë "gjeldeti - smerald" etj. Moore është një personazh i njohur i letërsisë, vlerësuar me çmime të ndryshme prestigjioze, si: "Bollingen", "Pulitzer" etj., një poete që nxiste ideaturë, imazhime, mbështetur mbi një gjuhë saktësisht të thukët figurative dhe konkludim të qartë mesazh-përcues. Për Moore, në një ese të shekullit të kaluar, William Carlos Williams do të shprehë: "...ajo e ndjen veten vorbull të ngjarjeve të mëdha" dhe vargu me pak fjalë: "Deti është një koleksionist", krijon një sintoni të paqte me atë që përben shpirtin poetik: kaltërsi, thellësi, akumulim, artikujë, frymëzim, ondulacion, vibrim, shtijëz, botë e dallgavitur me vargun në buzë...

Madje në Amerikë, poezia moderne e lëvruar aty rreth viteve 1900 deri 1940 e më pas, deri në ditët tona, na rikujton se këto nota kanë tingëlluar si metafizikë, duke synuar të shpjegojnë në varg natyrën e qenies dhe realitetin. Kjo praktikë solli një erë të re ndryshimi, duke renduar mes shpirtit të poetit të lirë dhe lëndës. Mjafton të kujtojmë këtu poetët: amerikanin Wallace Stevens, me krijme si: "Sunday Morning", "The Snow Man", etj, Marianne Moore, Hart Crane, Robert Frost, Mina Loj etj., të cilët thyen rekorde krijuese në skenën bashkëkohore letrare. Por, kjo vlen edhe gjermanin Gottfried Benn, spanjollin Federico Garcia Lorca e shumë të tjerë, të cilët në kohë të ndryshme rritën ngrehinën e lirikës. Kjo armatë poetësh lirikë në letërsinë botërore, duket se vjen më elokuate në vargun e tyre me meditime krijuese mbi natyrën, krijimin, familjen dashurinë, duke ofruar njëherazi edhe një pasuri shpirtërore. Këta poetë na vijnë më sensitiv dhe, herë - herë, vargu i tyre jep mesazh udhëzues e praktik dhe përjetohet njësoj prej lexuesit.

Elizabeth Bishop, poetja amerikane, lindur në Worcester Massachusetts më 1911, e cila me të drejtë është konsideruar si një nga poetet më të rëndësishme dhe të shquara amerikane të shekullit të XX, fare natyrshëm derdh në letër këto vargje: "Në 6:00 ne jemi duke pritur për kafe, / duke pritë për kafe dhe thërrime barnirësie / që do të ishin shërbyer nga një ballkon / si mbretërit e vjetër, ose si një mrekulli. Ajo

ishte ende errët. / Një këmbë e diellit, në një gurgullimë të gjatë në lumë"...

Pra, ku qëndron e veçanta e këtyre vargjeve? Ato janë dehëse, shprehin me origjinalitet një çast, një gjendje, një mëngjes... Vargu lirik troket vrullshëm dhe, për nga pikëpamja ndërtimore e strukturale, sjell një dukuri përmasative. Për hir të së vërtetës, lirika moderne ka tërhequr vëmendjen jo vetëm të letrarëve, por edhe të lingvistëve, sepse kjo lloj poezie ka imazh, shenjzon me anë të gjuhës, ka nocion, konvencionohet përmes tingullit dhe ngjyrave...

"Kujtimi për diellin në zemër u mpak / Bar i zbehtë. / Flokë të hershëm dëbore që larg / Era po nget", - shkruan kështu Anna Ahmatova, rusja e famshme që, ndonëse u kritikua për akmeizëm, u nderua me çmimet "Honoris Causa" dhe "Etna Kaorrina".

Poezia lirike ka një rrjedhë e natyrshme të dinamikë. Motivet vrulltojnë perceptivitetin më konkret dhe lexuesi është më i predispozuar drejt kësaj lloj poezie. Nëse do të ndaleshim te poeti zviceran, Andri Peer, ai ka një mënyrë tepër të veçantë, të natyrshme dhe të thjeshtë të ndërtimit të vargut, duke krijuar ura komunikimi fare të lirshme me lexuesin e tij. Le të citojmë prej Peer, katrenën: "Unë të lashë që ti të ikje / e lehtë dhe ajrore / me parfum vishnjeje dhe tymi / në buzët e tua gjysmë të mbyllura".

Lexo, sa me natyrshme: "...parfum vishnjeje dhe tymi". Është një ikje. Ajo, e lehtë dhe ajrore... Po pse parfum vishnjeje? Sepse dashuria purpuron all; e kuqe dashuria dhe po kështu parfumi. Jo vetëm aromatisë, por edhe vishnje, ndërsa tymtaja mbështjell mstershëm gjithë atë ikje me "...buzët e tua gjysmë të mbyllura". Lehtësisht kaq e perceptueshme dhe e thjeshtë kjo e poezi e Peer-it.

Lirika europiane e shekullit XX ka hapur për lexuesin një tjetër dritare komunikimi letraristik. Ajo nuk solli ndërlikime. Ishte e thjeshtë dhe pa konstrukcion kompleksual, ndonëse ka edhe autorë të tjerë që, megjithëse implementojnë vargun modern, bëhen edhe programatik, edhe të vetëkontrolluar.

E nisëm me poetët e huaj për të mbërritur tek ajo që ka gjetur një simbiozë dhe sinkronizim të paqte edhe në letërsinë shqipe. Mjafton të përmendim emra tingël-lues, si: Lasgush Poradeci, Martin Camaj, Azem Shkreli, Ali Podrimja apo Frederik Rreshpja, poetë këta aspak të dogmatuar, nga ndikimi i RealSoc-it dhe asfere konformal.

"Nga Camaj te Camaj" - do të formuloja një titull që "religjion" artin e lirizimit modern të poetit të njohur shqiptar që jetoi në kapërcyellin e një kohe të vështirë për fatet e vendit. Profesor i katedrës së gjuhës shqipe, "shejzëtar" të "Le Pleadi", Camaj sintetizon në shumëplanësi një poezi lirike që bëhet shpeshhershëm referenciale për studiuesit dhe kritikët. Poezia e shkruar para viteve '90 - të të shekullit të kaluar nga shqiptarët përtej Shqipërisë, pati dhe "privilegjim" që u shpreh lirshëm dhe pa indikesat ideologjike të sistemit të kohës të instaluar në vendin tonë. Kësisoj, poezia e Camajt shndërronet në "orën e kohës" që nuk i ka ndalur rrahjet e tik - takes në asnjë deqikë. "Poezia e Martin Camajt, në çdo ind të saj, është poezi shqiptare; që nga largësia ku

ishte e paracaktuar të krijohet, ajo fokusohej drejt hije - dritave të universitetit shqiptar, të cilat i kalonte pastaj aq imtësisht në kalein-doskopin e vet të papërsëritshëm që ishte edhe fyell, edhe organo, edhe arkaikonativist, edhe modern", - vlerëson studiuesi Ymer Çiraku mbi veprën poetike të Camajt. Për hir të së vërtetës, lirika e Camajt përfshin Shqipërinë e pacak, duke u mbështetur në vllugun e trikohësisë: dje - sot - nesër. Brenga e Camajt ka një timbrim të veçantë, një rreke e prajshme për t'u ngjitur në cakun e komunikimit të brezave, të elementimit të përcjelljes me natyrshmeri të fjalës së skalitur: "Ndëgjo, ti djal, pse na jemi pleq", për të synuar drejt mesazhit të qartë të stafetës apo sjellja e një poezie me një botë të qashtë, ku kodatura e asaj që përcjell poeti, merr vlera sentencore, duke u shpërfshqur si antologji të padiskutueshme e pakundërshueshme didaktike: "Por bijve të mij un kam u thanë tu' u rritë / Mos shkëlmi n'bukë, / Mos pështyni n'zjarrm, / Mos pështyni n'dritë!". (Poezia "Besimi ynë"). Buka - Zjarri - Drita - një konotacion "triniteti" mes një "tercine" moralizuese të Camajt... Poeti mbeti atje, tej Atdeut, nëmur e ëndërrimtar, liriku i papërsëritshëm, duke skalitur vargjet tharmites dhe emblematik: "Kur tallazi të bijë në pushim / e njimij birnë ujse kryepuzull të përshëndesin ngjyrat e agut / due me u kthye në jetë buzë ujit të kthjellët / që e njoh si veshen", - kjo është brenga e Martin Camajt për mungesën e dheut mëmë te poezia "Kthimi"... Ai ishte liriku që shkroi shqip, frymtoi shqip dhe përcolli artin poetik në të gjithë komponentët e duhur dhe i treti hapësirat përmes fjalës, duke bërë dhe që gegërishtja të fitojë nuanca të reja shprehëse.

Nuk kish se si të mbetej jashtë vëmendjes poeti Frederik Rreshpja, një nga zërat më virutalë të lirikës shqiptare të fundshekullit të kaluar, por jo vetëm. Rreshpe ka një varg të veçantë, të mbushur gjithë klithmë e dhimbje, një varg apostrofik që vajton me kujën e erës që cajat xhamave të akullit të ditës së ftohtë gri: "Një pemë në horizont si një njeri i braktisur. / Bien shirat mbi vetminë e saj, / Tringëlajnë telat e shiut / kur i bie violinës era".

Pema e vetnuar, njeriu i braktisur, shira që pushtojnë trup perme dhe tela të këputur shiu mbi "viloinimin" e erës - kjo është poezia e Rreshpes që, nëse do t'i shtohet një fjalë tjetër, do t'i zberret mrekullia ndërtimore. Ndërsa vargjet e Podrimjes bien aromën e dashurisë për tokën, vendlindjen, dheun e mëmës dhe të babës, cakun e të parëve, gurin e varrit, truallin e larë me gjak... "Unë, biri yt, Kosovë t'i njoh dëshirat e heshtura, / t'i njoh ëndrrat, erërat e fjetura me shekuj, t'i njoh vuatjet, gëzimet, vdekjet..."

E shkruar në formë elegjiake, madrigal, vjershë meditative, eklog, stanca, epigrame, poezia lirike është dhe mbetet një nga format më komunikuese me lexuesin. Vargu vjen i brishtë, i ashpër; i butë, por edhe i "sertë"; i tingullt, por edhe i memectë; i bukur, po edhe i mrekullueshëm. Ai bëhet rigëz çeltirës së kaltër të letërsisë... Bie, ngjitet, lakohet, bëhet lidhëz, josh, grish "mëkaton", kulmon, klith, belbet, trishtet e rend... Lirika ka thyer tribunalin e elitës dhe nektarit letrar. Ajo ka një shtrirje diametralisht universale dhe ka vesuar në të shkuarën, të tashmen duke shtruar traditën e së tejmes...



TARA

Afrim DEMIRI

Përditë shikoja në oborrin e shtëpisë së plakut Tara. Nga dritarja e vogël, hyja në shtëpinë misterioze, në të cilën nuk hynte dot, asnjë i huaj. Dita – ditës, ajo, u pat ba për mua, një kornizë e ditëve verore, në të cilën pamjet ndërroheshin, varësisht nga lëvizjet e përditëshmërisë së fqinjëve, të dajëve të mi. Nga të gjitha ato lëvizje që thurreshin si fijet e padukshme që lëshon një mari-mangë, kishte diçka që nuk lëvizte, në asnjë rast të vetëm. Dita fillonte dhe mbaronte me pamjen e plakut Tara. Shpesh harroja të zbrisja nga kati i dytë dhe ditë pas dite fytyra ime ishte bërë portret, në atë kornizë dritare. Derisa çdo gjë tjetër, si në ndonjë kaleidoskop përthehej në mijëra ngjyra fafuritëse, nën hijen e dendur të arrës, ai zinte vend me të le dielli. Lëshonte magnetofonin me këngët folklorike, jehona e të cilave përcillej nga shpati në shpat.

Në fillim nuk e kuptoja asnjë fjalë, nga ato kangë me za burrash, që shpesh ndërpriteshin me disa gërhamë grithëse. Meloditë me ritëm arkaik më ngjallnin parafytyrimin e turmave protestuese që shkonin drejt një linçimi. Frika zinte fill nën arrën e Tarës, e merrte formë të një shtëllunge dhe më përplasej për fytyrë nga frenxhia e shtëpisë dykatëshe, të ndërtuar me qerpiç. Rrjetat e mari-mangave më ngatërroheshin për flokë. Nga ajo dritare e vogël thyhej muri i zhurmës dhe nga pasthirmat e rapsodëve fillonte të derdhej gjaku dhe të dëgjohej troku i parakalimit të kuajve. Mesazhet e kangëve më vinin të largëta, tamam siç vinin nga kohët e shkuara, kurse fytyra e Tarës ndërronte pamje sipas ritmit të kangës. Herë-herë më dukej se vetë Tara po këndonte dhe zëri dilte nga ai, e jo nga magnetofoni i firmës gjermane "Grundig".

Të gjithëve Tara iu ishte bërë i padurueshëm me magnetofonin e tij. Krijohej besëtytnia se Tara me këngët e tija po ndillte zi për fshatin. Unë e përjetoja si të isha në një koncert dhe po vëzhgoja nga lartë. Për shumë kë, Tarës i ishte mbushur mendja se është vet heroi i këngëve kreshnike. Kurse fqinjët shpesh merrnin malin, po si të ishin kaçakët e këngëve apo muhaxhirë fati i të cilëve këndohej në ato këngë.

Tara jetonte gjatë. Çdo gjë duhej ta plotësonte epikën e epitetit. Edhe jetëgjatësia e Tarës. Për çdo verë unë vizatohesha në xhamin e dritares. Kangët filluan të depërtojnë në mua, por besa realiteti filloi të dalë nga kangët dhe të vërshojë në shtratin e lumit të shterur. Pyetja "ç'anë po knon ai zog i zi", po merrte kahje. Po kthehej si një shigjetë e zezë dhe po godiste zemrat e bashkëfshatarëve. Frika se kangët e Tarës do të sillnin kob filloi të jetësohej.

Korrja dhe fshierja e grurit me kombajë filloi të bëhet risi. Lama e kuajve po zinte vend në kujtime. Mirëpo kombaja e parë solli edhe vrasjen e parë. Sukajt e vranë djalin e Gavranëve.



Ajo verë u përgjak. Unë zbrita nga dritarja me bindjen se këngët e Tarës kishin faj që u vra Dili. Kisha dëshirë t'i prishej magnetofoni i Tarës. Tragjikja nuk jehonte më në vesh, por gërryente nga brenda, në zemër. Dilin e pashë të shtirë. E pamja zgjati gati dy muaj. Tara gjatë asaj kohe nuk e kishte lëshuar muzikën.

Ndalja e kangës ishte një paralajmërim fatkob edhe për Tarën. Tara më nuk doli në oborr nën hije të arrës. U dergj gjatë në shtratin e tij prej kashte. Thonin se as mysafir nuk pranonte. Fliste vetmevete. Më shumë thonin se murmuronte, sikur të fliste me Dilin. Dikush nga të afërmit pohonte se po i përsëriste refrenin e këngës "më mirë qiri i fikur se djalë i koritur". Në një ditë mes bubullimash ishte varrosur trupit i tij. Lajmi për vdekjen e Tarës kishte bubulluar gjithandej. Unë humba kornizën e dritares dhe strehimin tim arkaik.

Prej kur vdiq Tara, pushimet më janë dukur më të zbehta. Sa herë dëgjoj rapsodi, më duket se po e shoh fytyrën e Tarës, e cila asnjëherë nuk ma kishte dhënë një shenjë të vetme.

UDHËTARI

Fatmir Minguli

Ai nuk kishte udhëtuar kurrë në jetën e tij dhe çuditërisht kishte udhëtuar në shumë vende të botës. Kishte lexuar shumë nga "Udhëtimet e Guliverit" të Xhonatan Suiftit, dhe kishte përpilë pothuaj të gjithë librat e Zhyl Vernit që nga udhëtimet e nëntokës, të qiellit dhe udhëtimet e kapitenit Hateras. Por, në jetën e tij, asnjë udhëtim nuk kishte bërë. I vetmi udhëtim ishte ai nga Durrësi në Kavajë kur e fejuan me një kavajase. Ishte një udhëtim me trenin i atyre viteve. Po ishte në moshë krejt të re dhe peizazhet që shfaqeshin anëve të dritareve të vagonit ai pothuaj se i kishte harruar.

Por tani në një moshë pak a shumë të mesme, apo si të thuash në majën e parabolës së jetës ai vinte çdo ditë te "Xhoni Kafe", jo për të pirë kafën e mrekullueshme që bëhej aty, por për një fakt që ndoshta vetëm ai e kishte zbuluar. Bari ndodhej në zemër të sheshit të autobusëve, brenda hapësirës fatlume që përcillte udhëtarë, udhëtarë që kishin zgjedhur dikush autobusët, dikush tragjetet e dikush ndonjë mjet tjetër.

-Sot po nisem për në Firence - tha ai i vendosur katërcipërisht - i kam marrë të gjitha që nga pasaporta dhe veglat e rrojës, edhe bllokun e ditarit që do të mbaj sidomos te muzeu Uffici, edhe pastën e dhëmbëve e kam futur me kujdes...

Njerëzit që kishin prenotuar për në Firence, ishin grumbulluar pranë derës së autobusit dhe i tregonin biletat dhe tregonin bagazhet që prisnin me padurim t'i sistemonin në pjesën e poshtme të autobusit. Disa bërtisnin dhe udhëtarit i vinte plasje. Përse duhet të bërtasin këta njerëz, kur ata do të hipin në këtë autobus si aeroplan, ah, aeroplani, kur do të vinte dita apo radha që udhëtarit të hipte në një nga avionët jo të Air Albania, por tek ato të Swiss Air ...Dikush e shtyu udhëtarin dhe mbas një sekonde e gjysmë i kërkoi falje. Po hipnin të gjithë në autobus. Shoferi mbylli derën pneumatike të përparme dhe të prapme dhe autobusi u nis.

Udhëtarit po rrufiste kafënë në tavolinën e tij të preferuar dhe shihte gjithë kënaqësi se si autobusi doli nga sheshi i stacionit të trenit dhe mori drejtimin për nga hyrja te sheshi i trageteve.

Ai psherëtiu dhe papritmas kërkoi t'i sillnin një raki. Qazimi, kamarieri që kish mbi tridhjetë vjet që i shërbente, i solli teken e rakisë me gotë të madhe uji dhe i uroi udhëtimin për në Firence.

Udhëtarit bashkë me pasagjerët që zbritën nga autobusi u drejtua te policia e kufirit për të vulosur pasaportën. Policia bionde e pyeti se ku do të shkonte dhe pse. Ai i tha se do të shkonte në Firence te Uffici.

-Ou, sa mirë, bëji të fala xhaxhait tënd - tha ajo dhe e goditi fort fletën e pasaportës, duke e vulosur përjetësisht.

Duke pirë rakinë udhëtarit po mendonte për atë policen se ku e njihnte

xhaxhain e tij. Me të vërtetë ai e kishte një xhaxha, po ai jetonte në Shkallnur të Durrësit. Për një moment mendoi me vete se edhe policia sot kishte arritur suksese të mëdha në botën kibernetike. E punë e madhe se i dha të fala, rëndësi ka që ai kaloi dhe postin e doganës.

Koha e mëngjesit po kalonte dhe arixhiu i vogël, Xhixhi, kërkoi atë pesëlekshin e përditshëm dhe udhëtarit ia dha, ndërkohë që trageti ishte nisur dhe së shpejti do të mbërrinte në Ankona.

Udhëtarit nuk e shijoi aspak kafënë në barin e tragetit dhe para se të hipte në autobus iu lut shoferit që ta pinte një kafe në interieret e portit të Ankonës.

-Vetëm në Durrës dhe në Ankona e bëjnë ekspresin ashtu siç duhet - tha me vete udhëtarit.

-Kur u ktheve nga Firence?- po i thoshte Qazimi me një buzëqeshje të lehtë.

-Ja sapo u ktheva - i tha udhëtarit me gotën e rakisë përpara që kishte shkuar gjer në gjysmën e nivelit të një tekeje - u ktheva me avion.

Qazimi e dinte fare mirë problemin e udhëtarit, por pse ta shqetësonte.


-Pse me avion - e pyeti me ngadalë ai udhëtarin.

Po, në fakt ndodhën ca gjëra dhe u detyrova të vija sa më shpejt, ja siç e sheh këtë rakinë, prandaj e porosita se ai kamarieri i aeroportit në Firence më mori pesë euro për një grapa që ishte tridhjetë gram dhe jo pesëdhjetë. Në aeroportin e Rinasit është më keq...

-Ej, këto aeroportet - tha me vete udhëtarit duke menduar për disa syresh.

Kishte kaluar gati një gjysmë ore te Bar Xhoni dhe udhëtarit po mendonte për udhëtimin e të nesërme.

(Durrës, fund dhjetori, 2022)



Poezi Nafije Zogaj

TEKSA FLUTUROJE ME KRAHË ËNDRRASH

*Në kujtim të vëllait
Milazim Zogaj 22.11.1970-13.08.1982*

Nga dyert e drunjtat të larta deri në qiell
që për çudi nuk i mbyllte kush
si breshkë hyri një makinë e bardhë.

Kurrë nuk kisha parë
grumbull aq të madh njerëzish në oborr.
Qeni me ngjyrë deleje më mbështolli krejt
vetëm koka më mbeti jashtë.

Nuk e di sa gjatë dyert mbetën hapur
Nuk e di as kush i mbylli
E di vetëm që ti nuk ishe në shtëpi.
Me siguri ishe te dajat.

Nuk ishe te dajat.

I pyeta të gjithë me rend
dikush kthente kokën më një anë,
dikush më tregonte ndonjë përrallë
e dikush, dikush edhe qante.

Nuk ishe në shtëpi.

Fillova të të kërkoja vetëm
rrugëve, arave, lëndinave
e për çudi,
mua më kërkonin,
më vinin pas,
ty jo.

Askush nuk të përmendte.

Me siguri ishe në shtëpi.

Nuk ishe në shtëpi.

As te dajat
as në shtëpi
as te dajat as në shtëpi
as në shtëpi as te dajat
as te dajat as në shtëpi
as te dajat
as

derisa një ditë më zuri gjumi.

Kur u zgjova,
nëna më tha se tashmë isha
më e vjetër se ti.
Dhe sapo filloi të flasë për ty
më kapi një kollë
sa nuk u mbyta
në lumenjtë e diellit
që shpërthyen në fytyrën
e saj prej hëne.

Tash e di.
Teksa po fluturoje me krahë ëndrrash
papuritmas
krahët të ishin kthyer në flatra engjëjsh
me të cilët mund të kthehesh
vetëm mbi degët e mollëve të verës,
që lulëzojnë edhe në dimër,
para shtëpisë së vjetër,
për t'i dridhur gjethet
si atëherë kur fshihesh mes degëve
dhe kumboje me zë drite

"arushë, qe ku jam"

UNË ISHA ATJE

nuk dua të kthehem në të kaluarën

unë isha atje

dhe nuk munda ta shpëtoj
fëmijën që më rrëshqiste nga krahët
e mbytej në një pellg
të turbullt
të errët
të thellë

edhe pse ëndrra m'u përsërit
sa herë

SHENJAT NË MUR

dielli rrëshqet mbi majat e bardha të bjeshkëve
mbi qeleshën e bardhë të gjyshit
mbi mustaqet e tij
futet nëpër llullën e qelibartë
dhe ndalon
në murin prapa dritares

aty ku duhej të ishte shenja e radhës
e asaj dite
që nuk perëndoi

TOKA E ASKUJT

në fshatin tim
është një lëndinë e madhe
dhe një mal i madh
që nuk janë të askujt

në atë mal
lisat priten veç për dërrasa varri
dhe veç për varre hapen gropa
në lëndinë

SHTEGUT PËR NË ITAKËN E VET

si çdo natë tjetër
Penelopa ishte duke shthurur
ëndrrat që kishte thurur ditën
kur padashur
preu
kërthizën e zemrës

hëna rrëshqiste nga një gropë në tjetrën

një aromë
që nuk e kishte ndjerë qyshkur ishte fëmijë
e bëri të ngrihej

e tërhoqi si drita fluturën
shtegut
për në Itakën e vet

ME SYTË E MI E PATA PARË

kurrë nuk e harroj
kur për herë të parë e pata zbuluar
kur vetë
me sytë e mi e pata parë
që hëna
me të cilën mburresha
dilte edhe mbi oborrin e shoqes sime

pastaj si në faj ulte kokën
më shikonte me bisht të syrit
dhe më përcillte për në shtëpi

NUK NA BËN ZEMRA

aty kah fundi i oborrit
afër derës së sokakut
kishim një mollë
frutat e së cilës ëmbëlsoheshin
vetëm në dimër
pasi i shtrinim në tavan

nën atë mollë
një ditë dimri
nga dritarja
pashë babain
duke ia prerë kokën Laroshit
të voglit të lopës Larë
që e kishte përkëdhelur
si mua

ai ishte
sa unë

tani që nuk është më
as molla e dimrit
as babai
kemi mbjellë mollë të vjeshhtës
dimrit blejmë mollë nga vende që kanë shpikur
të tjerë diej


edhe mish blejmë
ose paguajmë të tjerë që t'i therin kafshët
nga që nuk na bën zemra
t'i therin vetë

**HËNA VEZULLONTE NË
TË VERDHË TË VDEKJES**

e hapi dritaren


ishte hera e dytë që
brenda së njëjtës natë
u zgjua nga i njëjti ankth
ku nëna
siç ishte nënë i bëhej fëmijë
dhe teksa i jepte gjë
shndërrohej e tëra në qumësht
që i rridhte nga duart
nga gishtërinjtë

hëna vezullonte në të verdhë të vdekjes
toka bënte sikur po flinte



MBI UNIVERSIN POETIK TE FATOS ARAPIT

"Universi..." e trajton Arapin në mënyrë poliedrike, duke paraqitur profilin e tij sa në poezi, aq edhe në mendimin etnologjik, në kritikën letrare, në prozë, dramaturgji dhe fushën e përkthimeve



Nuri PLAKU

Monografia "Universi poetik i Fatos Arapit" i autorit Bardhosh Gaçe është një prurje e re në botimet kush-tuar poetit dhe një dimension i ri i vlerësimit të figurës dhe krijimtarisë së tij të gjithanshme. "Universi..." e trajton Arapin në mënyrë poliedrike, duke paraqitur profilin e tij sa në poezi, aq edhe në mendimin etnologjik, në kritikën letrare, në prozë, dramaturgji dhe fushën e përkthimeve.

Libri hapet me një analizë të hëollësishme të zhvillimeve në letërsinë shqiptare të viteve '60 të shekullit të kaluar, duke krijuar kështu sfondin e plotë historik, për të inkadruar profilin krijues të Arapit. Njëpër një kësaj analize, Gaçe rishtrukturon kontributin e brezit të ri të krijuesve të kësaj periudhe, të cilët u shfaqën si një "bum" letrar shoqëruar me reaksione dhe kundërshti të brezit paraardhës. Në këtë analizë të bie në sy fakti se ai nuk e

veçon Arapin nga kolegët e tij, por e shoqëron atë gjithnjë midis tyre. Në këtë mënyrë, autori rikonfirmon mendimin kritik për hierarkinë e vlerave tona letrare, të cilat e vendosin Arapin në treshen më të mirë të krijuesve shqiptarë krahas Kadaresë dhe Agollit.

Monografinë Gaçe e pasuron me referenca nga të gjithë kritikët dhe studiuesit e letërsisë shqipe që janë marrë me Arapin, duke e kompletuar mendimin e tij me vlerësime të gjithanshme dhe elitare. Kjo tregon për një punë të thelluar, e cila e kthen librin në një botim serioz e mjaft të rëndësishëm. Por, ajo që të bije më shumë në sy, është dashuria e tij për poetin, të cilën e përdor si një "aureolë" pas çdo mendimi e çdo reference. Kështu, kur shkruan për tematikën e poezisë së Arapit, Gaçe veçon "me hatër" temën e detit e të vendlindjes dhe hedh dritë shpirtërore mbi interpretimin e saj. Ai citon pjesë nga studiuesi kosovar Sh. Galica, i cili jep inversin poetik të lamtumirës së

Arapit "pa lamtumirë", duke evidentuar pejëzat mikroskopike të lidhjes së poetit me Vlorën; jodin dhe kripën, të cilat i qëndrojnë në plasaritjet e buzëve. Pikërisht këtyre "pejëzave" Gaçe iu mbivendos "pikturën" poetike të Zvërnecit në ciklin "Perëndim dielli në Zvërnec." Në interpretimin e Gaçes elementi poetik i Arapit merr më shumë dritë, e cila bie mbi vendlindjen e tij si një brerore që e shenjtëron atë. Kështu, p.sh., tek poezia e dashurisë, krahas interpretimit të zakonshëm, ai krijon edhe një shtresim të ri të panjohur më parë për Arapin, sidomos te poezia "Tana", ku përcakton karakterin e saj ekzistencial. "Poezia Tana në të vërtetë është e natyrës ekzistenciale, - thotë ai, - pasi brenda saj ka diçka hyjnore, apo e thënë ndryshe, diçka shenjtërore."

"Tana," një poezi e ngarkuar me mall e dhimbje të thellë njerëzore, është në të vërtetë një nga perlat e Arapit, një nga ato që e nxjerrin krijimtarinë e tij nga mjegulla soc-realiste në lirinë e epërme emotive. Gaçe e pasuron interpretimin e tij edhe me pasazhe nga intervista e Fatosit me Tanjën në vitin 1987 dhe kjo e deshifron edhe më shumë kuptimin e saj. Madje, me këtë shtojcë, Arapi del më hyjnor se vetë poezia e tij.

T'i shtosh poezisë së Arapit shtresime të reja interpretoese, do të thotë të dëshmosh se ajo është burim i pashtershëm vlerash. Nga kjo pikëpamje, Gaçe me librin e tij sjell një kontribut të ri në mendimin kritik shqiptar, i cili duhet konsideruar një "mbivlerë" që i vendoset profilit krijues të Arapit.

Në monografinë e tij, Gaçe jep peizazhe interesante nga poezia e Arapit, duke "luajtur" me impulset energjike të mendimit. Ai analizon, komenton, interpreton në mënyrë lineare e befaz shkëputet nga ky plan e del mbi kumtimin e vet. Kemi një hapësirë "bosh" të mendimit të tij, e cila i lë vendin e duhur perspektivës poetike të Arapit. Kështu, p.sh., kur shkruan për poezinë intime, ai thotë: "Janë poezi të një vokacioni të veçantë, një qasje e epërme në gjithë poezinë shqiptare, që kërkon analiza të veçanta interpretimi tekstual dhe estetik." Ndoshta me këtë "analizë të veçantë interpretimi" autori presupozon një tjetër përmasë të munguar të Arapit, atë të relacionit me poetë të tjerë ballkanikë e europianë, që i kanë kënduar aq shumë detit dhe vendlindjes së tyre. Ky rrafsh krahasues do të hidhte më shumë dritë mbi potencën artistike të poezisë së tij dhe do ta zgjeronte rrezatimin e saj në universin e vet poetik. Një nga poetët ballkanikë që i kanë kënduar më shumë detit, është Ricos. Cili është relacioni poetik midis tyre? Po me poetët e Luftës së Dytë Botërore? Ka ardhur koha që poetët shqiptarë duhet të vihen në balancë me sivëllezërit e tyre bashkëkohorë, sidomos me ata europianë. Mjafton të veçojmë metaforën interesante: "Pulëbardha e ngjeshi gjurmën/ mbi zërat e bardhë të kaltër-

sive" ose: "Mu në mes të emrit Vlora vetë,/ futa një çafkëz që loz me rrufetë " për të nënkuptuar vendin e nderit që zë Arapi në këtë korrelacion. Ky impuls energjik i mendimit të Gaçes, kjo shkëputje nga plani i tij i gjykimit linear, është në fund të fundit një shprehje potenciale e poezisë së Arapit që dëshmon thellësinë dhe vazhdimësinë e saj në kohë e që ai, me thjeshtësi, nuk e konsideron aspekt të shteruar nga puna e vetë, por një mundësi interpretimi të së ardhmes.

Gjithsesi, Gaçe në monografinë e tij nuk e përjashton këtë dimension të Arapit. Ai e vendos poetin në kuadër evropian, duke dhënë ndikimin e tij nga shkollat e zhvilluara letrare dhe rrymat e ndryshme, sidomos ajo e ekzistencializmit francez, strukturalizmit, apo ndikimit filozofik nga Shopenhaueri, Kiekerardi etj., kryesisht në poezinë e pabotuar apo atë të pasdiktaturës. Ai sjell gjithashtu edhe studimin korrelativ të Prof. Gradilone, i cili e kundron Arapin në pika takimi me disa prej poetëve më të mirë të letërsisë botërore. Ndërsa studiuesja E. Ymeraj sjell korrelacionin poetik me "Fjalët" e Jose Saragomango dhe "Ditë tiranase" të Fatos Arapit. Por, këto natyrisht janë fragmentare përpara sistemit metaforik të Arapit dhe korrelacioneve me poetë të tjerë, që hedhin më shumë dritë mbi poezinë e tij.

Një tjetër prurje e Gaçes në këtë monografi është edhe ndërtimi i "kurbës" poetike të Arapit. Kulmi i saj arrihet me ciklin kushtuar Vllasit. "Është cikli më i bukur dhe më me peshë në poezinë e Fatos Arapit," pohon autori dhe ky konstatim harmonizohet edhe me mendimin e përgjithshëm letrar. Ky cikël e ngre Arapin në një dimension të paarritur më parë dhe as më pas. Te ky cikël "monument poetik" siç e quan Podrimja, Arapi e zhyt thellë e më thellë plugun poetik dhe nxjerr prej thellësisë perlat e mendimit të vet filozofik. Është pikërisht ky cikël që shpalos në mënyrën më të plotë e të kompletuar dimensionin evropian të krijimtarisë së tij poetike. Këtu, ashtu si te "Tana", Arapi thith të njëjtin ajër artistik me sivëllezërit e tij bashkëkohorë kudo që të jenë nëpër botë.

Një pikë takimi me letërsinë europiane janë edhe përkthimet e Arapit. Sjellja në gjuhën shqipe të Safos, Nerudës, Vapcarovit, Matevskit, Popovskit etj. tregojnë shijet e tij poetike dhe shërbejnë si piketa për orientimin e tij drejt artit botëror.

Një vend të rëndësishëm në monografi zë edhe mendimi letrar dhe etnologjik i Arapit. Ky kapitull hedh dritë mbi këndvështrimin kritik e letrar të poetit dhe trajton një tjetër dimension të tij. Ai analizon prurjet poetike të krijuesve të rinj, si I. Zhupa, B. Mustafaj, P. Zogaj, I. Duraku, E. Ballauri, F. Myrtaj, Xh. Tosku, B. Xhaferri, M. Buçpapaj etj., të cilët i mbronte dhe i nxiste për prurjet e tyre të reja, për elementin qytetar dhe modernitetin e spikatur për kohën. Ajo që thekson Gaçe qëndron në

faktin se është fisnikëria dhe guximi i këtij poeti që motivon vlerësimin dhe mbështetjen e poetëve të rinj. "Arapit, - thotë ai, - ka mbajtur një qëndrim të guximshëm në mbështetje të tyre". Mbi të gjitha ky guxim i Arapit dëshmon shprehjen e lirisë së mendimit të tij në diktaturë. Jemi në vitet '70 dhe ai orienton letrarët e rinj për liri krijimi brenda tematikës që ata njohin, duke kundërshtuar mendimet socrealiste, se një poet duhet të ketë larmi tematike. Ndërsa për mjeshtrinë artistike në poezi, ai këshillonte figuracionin. Me këtë mbështetje Arapit ka dëshmuar orientimin e tij artistik, njësh me mendimin më të përparuar të të gjitha kohërave, të të gjithë shekujve që nga Aristoteli deri te babai i semiotikës ruse, Juri Llojman se "poezia flet me gjuhën e figurshme".

Mendimi etnologjik i Arapit, profilohet në studimin "Këngë të moçme shqiptare." Gaçe jep informacion të bollshëm mbi këtë fushë, duke e rivlerësuar Arapin si studiues dhe njohës i Ciklit të Veriut. "Arapit, - shkruan ai, - ka sjellë një perceptim të veçantë të studimit me anë të koncepteve filozofike, duke i krijuar lexuesit dhe studiuesit mundësi perceptimesh". Më tej ai evidenton edhe veçorinë individuale të Arapit si studiues, praktika e të cilit shmanj hiperbolizimit dhe elementet fantastike të mitit, duke u përpjekur t'i ofroj lexuesit "një praktikë eksploruese, më tokësore dhe më komunikuese".

I tillë ka qenë Arapit. Një mendje elitare që "urdhërohej" nga një shpirt i kaltër, ngjyrosur me blunë e ujërave të Jonit. Kjo duket edhe në analizat moderne që u bën ai Safos, Naim Frashërit, Ali Asllanit, Vorea Ujkos dhe Petro Markos. I madhi për të mëdhenjtë. I ngjashmi me të ngjashmit. Në trishtimin dhe dëshpërimin e Asllanit e të Markos, Arapit shihte vetveten. Ishin të njëjtat ujëra ku notonin shpirtat e ndritur të kombit. Vrasja e mistershme e të vëllait, Vllasit, presioni partiak që kulmoi me akuzat për hermetizëm, dekadentizëm, simbolizëm dhe ndalimin e dramës së tij, "Drama e një partizani pa emër", dëshpërimi i thellë për ndarjen e imponuar nga Tanja, e dashura bullgare, i bënë ata "vëllezër Hamlet" të një vendi, të një atdheu, të atij atdheu "plot diell e pa dritë", siç thotë në një nga poezitë e tij. Nga kjo pikëpamje mendimi letrar dhe etnologjik i Arapit plotëson breroren e tij poetike dhe më shumë se kund, kjo shfaqet në faqet e këtij botimi.

Në fund autori e përfundon monografinë me një vlerësim të drejt-përdrejtë e tepër të ndier për figurën e Arapit. Në këtë kapitull ndihet dhimbja që lidhet me 11 tetorin 2018, datën e ndarjes së tij nga jeta. Ndihet rënkimi i Gaçes si një gjërmim dallge nga ato të brigjeve të ashpra të Jonit. "Letërsisë shqipe, - thotë ai, - do t'i mungojë petku blu". Dhe është pikërisht "petku blu" ai që e bën ikjen e poetit pa ikje. Sepse, nëpërmjet tij ai do të shfaqet sërish e sërish midis nesh.

Kështu do të mbetet poeti Fatos Arapit, i gjallë e gjithmonë pranë nesh. Por, më pranë se kurrë atë e sjell Prof. Bardhosh Gaçe me monografinë e tij "Universi poetik i Fatos Arapit," një vepër që e ngre në piedestalin e nderit poetin dhe njëherazi edhe vetë autorin e saj.

Interpretime

ANALOGJIZMI SEMIOTIK I UNIT SI PASQYRË E SË KALUARËS

(Rreth veprës "Labirintet e shpirtit" të Ermelinda Alushani Myzeqarit)

Emine BORIÇI

Ermelinda Alushani Myzeqari na prezantohet me veprën letrare "Labirintet e shpirtit", e strukturuar në skica që në impaktin e parë duken sikur janë të fragmentarizuara, të veçuara pa një lidhje kuptimore logjiko-kronologjike me njëra-tjetrën, por në të vërtetë subjektet kanë linja analogjike mes tyre duke krijuar viciozitetin e veprës. Myzeqari na servit trembëdhjetë tregime ku "Elegji për veten" përmbledh të gjitha minitematikën e trajtuara në skicat e para apo pasardhëse si: figura komplekse gruas në para dhe paskohësi, kapërcimet kohore analepsike e prolepsike duke dhënë konceptin e ndërlikuar të jetës, figurat mitike dhe neologjizmat si një tipar dallues i vet autores.

"Elegji për veten" ky titull konotohet ideologjikisht mbi narratoren personazh që nuk identifikohet, por merr trajta mbarënjëzore, unifikohet me vetë lexuesin duke bërë vizualitetin dhe akustikën njësh me raportin e personazh-lexuesit. Çdo individ që futet brenda Botës së Trilluar rrëmbet nga rrjedha e ngjarjeve duke parë, dëgjuar ecur e vrapuar njëkohësisht me personazhet, e në këtë drejtim themi se lexuesi është emotivisht i përfshirë në vepër.

Autorja e ka emërtuar këtë bllok narrativ si eksperiment letrar për të tejçuar funksionin njohës të vetvetes me të tjerët, bosht ky që përshkon këtë skicë, e cila përndahet në një numër të caktuar pjesësh në lidhje semiotike mes tyre. Autorja jo pa qëllim e nis këtë eksperiment letrar me simbolin e guaskës për të sendërtuar thelbin e qenies njerëzore i cili është shumëfaqësh. "Duhet të kesh ftohtë për tu mbyllur në guaskën tënde. Dhe, po bërë këtë, ti je e tëra, e tëra brenda VEHTES. Fatkeqësisht vetja, uni, është gjithnjë një mozaik e për të krijuar Mozaikun e shpirtit vetjak, në breg presin guaskat bosh..." Jo pa qëllim është dhënë guaska dhe deti, dy element që mbizotërojnë në këtë skicë duke formuar një lidhje harmonike ku guaska mfsheh defekte e ndrydh ndjenja të ndrojtura duke i ruajtur ato me fanatizëm, madje as deti nuk depërton brenda për të kapërcyer në katarsis, por shihet si prolis grotesk në sfondin e shfaqur për atë çka është dhe çfarë bën.

Guaska diametralisht ka një gjatësi jo fort të favorshme për të sistemuar

një objekt a send qoftë edhe e minimizuar, por rrezja përshkruese e saj lejon letraritetin të palimseojë kujtimet, e Myzeqari këtë teknikë përqaset te postmodernizmi. Në shtresën e parë palimseojë kujton me mall nënoken si një femër me vlera të larta shoqërore mbi bazën e moralit dhe virtytit që gjyshja kishte ndërtuar jetën e saj e pas kësaj në një fluturim pegasik kthehet pas në kohë duke na e treguar gjyshen, nuse e cila e përndjek fatkeqësia pasi bashkëshortin e parë ia vrasin. Vetë jeta të destinon për të rrugëtuar shtigjeve të reja të saj e kjo nuse martohet sërish, por mbetet peng e dashurisë së parë, një brengë e pashërueshme, një rrugë e labirintit që të shpie në vorbullën e pashmangshme të tjetërsimit. "Nënokja ime dashuronte akoma. Ai nuk ishte gjyshi im."

Gjendemi përsëri te kthimi pas në kohë ku shkurtimisht na paraqitet nusja në shtëpinë e bashkëshortit të saj e ëmbëlsisht rrëfimi merr një tjetër rrjedhë. Njohim një tjetër personazh që përplotëson personazhin protagonist, Qerim Beu, gjyshi i narrorit që rrëfen më vetën e parë duke e bërë ligjërimin vlerë të vërtetë të shenjës letrare. Qerimin e konturojmë si një njeri autoritar e këtë qëndrim e tejçon gjenetikisht "stërgjyshi, gjyshi, ati, unë...në qoftë se do të bëjmë një analizë logjike unë dhe Qerim Beu do të ishim bindja dhe perëndia." Pra, formimi i personalitetit te këta protagonistë kishin një referencë ndonëse e vjetruar për modernizmin, Qerim Beu ishte ikona e admirimit të tyre.

Pse themi e vjetër? Marrim shkas nga etimologjia e emrave në skicë si: Qerim, fjala nderuese Beu, Xhemal, Resul e duke përqasur kohën të të cilën datojnë këto emra edhe kultura aludohet të jetë e tillë. "Unë do të martohem e do të bëj shumë djem. Djemtë do të më puthin dorën. Nusët do t'i rrok me kamxhik e pastaj do t'i mbyll në hajatin tij. Të gjithë do të ma kenë frikën." Sintagmat emërtuese si: puthja e dorës, rrok me kamxhik, do ma kenë frikën tregojnë mendësinë e shumë shekujve më parë e cila segmentohet edhe në vitet vijuese pas këtyre personazheve duke ruajtur tashmë traditën e të parëve.

Ky realitet duket sikur përmbyll ciklin e tij duke i lënë vend një diskursi tjetër, por në të vërtetë është vazhdim i parabolës së rrëfimit. Funksional-

izimi i elementëve të unit me tjetrin formëson strukturën imagotopike të narrorit prezantues. Kemi një shpëputje nga hemisfera e parë e kontekstit duke vijmësuar te jeta e personazhit "unë". Në pamje të parë duket sikur ka nota autobiografike në këtë gjysmën e dytë të skicës, por nuk hezitohet të themi se ky protagonist i paemër nuk është autorja pasi teoria e letërsisë thotë që kemi një distancë midis autorit dhe narrorit i cili ligjërimon ngjarjen. Duket kompleksike dhe antonimike me pjesën e parë të skicës që na paraqitet hijerëndë, autoritare dhe me një qëndrim të akullt, kurse në pjesën e dytë jepet jeta në qytetin "T", qytet ky që të fal kënaqësi shpirtërore dhe trupore. Erotizmi si një tipar postmodernist mbizotëron në tregim, ndryshe nga pjesa e parë që që erotizmi fshihet në errësirën me të thellë të guaskës. Ky personazh i unizuar martohet e vishet me të bardha. Kuptojmë që ishte një vajzë e bukur dhe hirplotë, por brezi i katërt i Qerim Beut, i cili ndonëse i vdekur "frymonte" me personazhin tonë. Na krijohet një lojë narrative e gjerë ku të gjallët dhe të vdekurit qëndrojnë bashkë, e kjo rimarrje kutive na pozicionon te rëndësia që i jepet individit si qenie njerëzore, sikundër protagonist që shprehet "Unë buzëqeshja, por sytë nuk i shqisja nga cepi i dhomës, ata ku qëndronin paraardhësit e mi të vdekur."

Vajza e përfundon jetëtregimin e saj duke na treguar që e mira dhe e keqja gjenden të dyja brenda unit të individit në të cilën është në luftë të vazhdueshme me vetveten. Këtë e shpreh te epilogu i cili ka funksion përmblyllës për shkrimin prezantues, tregimin nga i cili kuptojmë që shpëlarja e shpirtit nuk është deti, por mbyllja te guaska dhe siguria që askush nuk mundet ta lexojë e ta deshifrojë jetën individuale.

Ermelinda Alushani Myzeqari autore postmoderniste që me një elegancë shkrimore mpleks lexues të specializuar për të zbrëthyer kuptimet e drunjtë të ngritura në abstraksion duke u afruar më pranë kuptimit pasi ne jemi koshient që kuptimin e mbart dhe e gëzon autori dhe studiuesit përqasin interpretimet e tyre, pra një kuptim dhe shumë interpretime e ky ishte një interpretim modest për skicën "Elegji për veten."



Vështrim

GJETJA E NJË "DIAMANTI" QË RREZATON FORCËRISHT SHQIP

(Mbi librin "Zjarri Arbëror i pashuar" i prof. Bexhet Asani)

Nexhmije Hasani

Të ndodh një impakt ngazëllues, sapo merr në dorë këtë vepër dhe e shfleton për ta lexuar. Vë re, menjëherë, dashurinë dhe pasionin për ruajtjen e kulturës dhe traditës Arbëreshe. Titulli i librit më kujtoi veprën "Yjet e pashuar", kur në ato vite e lexonim me një frymë jetën, aktet e dëshmorëve të atdheut dhe zemra rrihte me të shpejtë nga dashuria dhe dhimbja për ta. Ne krenoheshim me ta dhe e njëjta ndjenje krenarie po më ndodh dhe tani, teksa më shfaqen heronjtë e letërsisë, artit, kulturës për ruajtjen e gjuhës Arbërore, traditës e më gjerë.


Ndaj, në këtë kontekst, mund të shpreh se Prof. Bexheti, si studiues profesionist kërkon ta ruajë dhe kultivojë me fanatizëm këtë traditë, duke i nxitur vëllezërit tanë, kudo në Botë, të vazhdojnë të ruajnë gjuhën dhe zakonet se, vetëm në këtë mënyrë, duke e trashëguar gjuhën tonë në breza, mbahet gjallë, në të kundërtën ndodh procesi i shuarjes, apo i asimilimit të saj nga gjuhët e tjera.

Një shtet pa gjuhën e tij është në kuptimin figurativ si një "peshk" i lënë pa ujë. Në të tillë rast, shteti mbaron, asfiksohet, atrofizohet dhe humb emrin e tij në hartën gjeografike. Ne jemi sulmuar ndër shekuj nga shtetet fqinje, që kanë vepruar maksimalisht me dashakeqësi për të eliminuar gjuhën tonë, por nuk ia kanë dalë. U jemi përgjigjur dashakeqësive të tyre me sakrificë dhe sakrilegje për të ruajtur gjuhën tonë amtare.

"Të dashur motra dhe vëllezër, ju e keni ruajtur gjuhën e Skënderbeut, veshjet, zakonet, traditat, kulturën shpirtërore, folkloristikën, këngët dhe vallet për 550 vjet. Tani, e vetmja gjë që duhet të ruajmë me vetëdije e të mbrojmë është arbërishtja, është tendenca e hyrjes së gjuhës arbëreshe, si lëndë obliguese në shkollë". A nuk tingëllon kjo si një lutje para Perëndisë? A nuk shohim një rilindës të kohës së sotme të spikatur në dashurinë dhe kujdesin e tij për ruajtjen e gjuhës?

Prof. Bexheti kurrë nuk ka hezitur t'i bëjë thirrje në formën e klithmës, qeverive shqiptare, që të veprojnë me seriozitet në këtë çështje. Ai vetë është një shqiptar i vërtetë, ku vitet e jetës së tij ia dedikoi mësimdhënies për rritjen dhe formimin e brezave, për t'i pasuruar me dije dhe kulturë. Sa më shumë njerëz intelektualë e të suksesshëm të ketë një vend dhe sa më shumë punohet e pasurohet gjuha e atij vendi, aq më i fortë është shteti, ku ata jetojnë e kontribuojnë.

Qëllimi i tij është gjuha, e shkruara dhe e folura, ruajtja e gjuhës. Edhe pse interesimi i shqiptarëve dhe arbëresheve është i gatshëm për bashkëpunim e veprim reciprok, në përkushtimin e organizimeve shkencore për gjuhën si seminare, konferenca e simpoziume ndërkombëtare për gjuhën, letërsinë, kulturën, përsëri



brezi i ri nuk e flet arbërishten dhe ky është dëm i madh i pallogaritshëm i parikuperueshëm, nëse nuk punohet me seriozitet për mos humbur gjuhën. Profesor Bexheti është vizionar, projekton për të ardhmen, duke qëndruar me këmbë në tokë, por gjithmonë në kontakt me dimensionet kohore: e kaluara tashmja dhe e ardhmja.

Një nga synimet e tij madhore në këtë libër është pasqyrimi tipik e real i figurave të njerëzve të mëdhenj që kanë punuar e punojnë për gjuhën shqipe si studiuesi Aristidh Kolja, shkrimtari e studiuesi Dinos Koubatis, profesor Talo Elma - etnolog, regjisoria Luçia Martine e shumë e shumë të tjerë, në një "hartë" të madhe gjeografike, ku ka njerëz me prejardhje shqiptare. Gjatë leximit të librit "ndjen" të ecësh në gjurmë të arbërishtes, duke përshkruar fshatra e zonat, qytetet e shtetet, ku jetojnë arbëreshët dhe shqiptarët e emigruar.

Mbijetojat e gjuhës arbërore (arvanitase) i gjejmë të shtrira në të gjitha zonat e Greqisë, arbëreshen në jug të Italisë, ku flitet akoma, pavarësisht se në ato zona rinia ka kohë që ka emigruar dhe kanë ngelur vetëm moshat madhore dhe kjo gjendje lë për të dëshiruar. Po kështu, në qytetin e Zarës në Kroaci, në fshatin Mandricë në Bullgari, në fshatin Karakurt në Ukrainë etj. Ky libër, përveç informacioneve, është i pasuruar me një "mini-fjalor" të gjuhës arbëreshe, me tekste këngësh e poezish të vjetra arbëreshe.

Kënga arbëreshe vjen nga thellësia e Tokës, prandaj dhe përcjell dashuri të madhe për ta gjetur e studiuar sa më shumë atë. Gëzimi i prof. Bexheti, kur në duar pati librin "Qefiti dhe

folmja e tij", ishte emocionuese. "Një ndjenjë rrëqethëse që më përshkoi trupin dhe shpirtin, - shprehet ai. Ishte një dhuratë e çmuar dhe vepër për shkencat albanologjike". Prof. Mario në monografinë e tij "Chieuti e la parlata arberechi" ka përdorur edhe materialin shkencor bibliografik, që në këto raste, është më se i domosdoshëm. Në atë libër janë të përfshira kostumet popullore, traditat e Qeftit. Në histori janë përfshirë, gjithashtu, ritet bizantine, ritet e pagëzimit, të cilat ilustrohen edhe me fotografi.

Arbëreshët gjatë 550 vitesh e kanë ruajtur me fanatizëm gjuhën e tyre. Është për t'u habitur nëse krahason kohët gjatë atyre shekujve, Ata, të izoluar në vetvete, nuk pranonin as krushqi të bënin me raca të huaja, edhe me vendasit, si arsye e vetme për të mos humbur gjuhën e zakonet, për të mos përzier gjakun dhe, në ato shekuj të izoluar nga sundimi turk, i cili kërkonte me insistim të madh të na vriste gjuhën, kulturën, traditën. Prof. Bexheti merr pamjen, me plot të drejtë, si një "arkeolog" i zbulimit të historisë arbërore. Ka punuar shumë për të mbledhur, sistemuar e seleksionuar informacionet nga të gjitha trevat shqipfolëse. Jo më kot e theksoj se ky libër të krijon bindje të forta, ka produkt gjuhësor, si dhe mbi të gjitha, vijueshmërinë e treguar mbi ngjarje dhe fakte të dokumentuara shkencërisht. Me një kurajë dhe nismë pasionante, ka mbledhur ngazëllimin jetësor, terminologjinë letrare arbëreshe dhe përdorimin origjinal të gjuhës, si një rit i përbashkët me traditën, kostumografinë dhe gjithë bukuritë e këtyre vendeve.

"Gjaku ynë i prishur", është libër nga Mbuzati. San Giergo është fshat

në provincën e Kozencës së Kalabrisë. Ai na tregon se në këtë fshat ka libra që flasin për historinë, folklorin dhe etnografinë e katundit, të cilat janë punuar me përgjegjësi shkencore. Të gjitha informacionet i gjen lexuesi në këtë vepër dimensionale, sepse prof. Bexheti ka ndjekur këtë rrugë njohurish, që në rininë e tij e më tutje në katedrat universitare. Duket sikur dëshira dhe pasioni e kanë ndjekur hap pas hapi, gjatë të gjithë rrugëtimit të tij jetësor e shkencor.

Në libër është një fotografi origjinale, mes shume e shumë të tjerash e zotit Bexhet me Atë Antonio Belushin, studiuesin e njohur arbëresh. Një rastësi e bukur i takon ata dhe i bashkon me një grup të rinjsh arbëreshë, të cilët udhëtonin drejt Prishtinës për të qenë prezent në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës shqiptare. Në gjakun e tyre vlon dashuria ndaj gjuhës e traditës shqipe. Antonio Belushi, etnolog, diplomuar për filozofi e teologji; Konstandin Bellushi, studiues i letërsisë italiane si dhe mësues i gjuhës shqipe për shkollat e ulëta. Gjithashtu, master të mbrojtur për gjuhën arbëreshe; Prof. Xhuzepë Skiro Di Maxhio, udhëheqës i Katedrës se Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermos; Prof. Zef Kjaramonte e shumë e shumë të tjerë, të cilët do t'i njihni me detaje në këtë libër me informacione dhe biografi të plota, duke plotësuar kështu njohuritë Tuaja për këta studiues të përkushtuar të etapës së sotme të kulturës dhe traditës arbëreshe.

Në këtë libër do të gjeni poezi arbëreshe, biografi të ndryshme, ngjarje, takime, gjurmë, fotografi dhe vepra të studiuesve të veçantë të profilizuar. Të gjitha këto me synimin e vetëm: shpалosje e veprimtarisë së madhe studiuese, analitike, shkencore në favor të ruajtjes së traditës së gjuhës arbëreshe.

Ja, si shprehet Francesco Rido për çështjen arbëreshe: "Asimilimi është problemi më i madh për ne arbëreshët. Unë dhe gjenerata ime, të cilët kemi ruajtur gjuhën arbëreshe për 550 vjet, nuk e kemi të lehtë ta përcjellim atë në brezin e ri, kjo për arsye se nuk bëhen më martesat brenda njëri - tjetrit. Nuk mbahet tradita dhe emigracioni një faktor tjetër vrasës për gjuhën e zakonet".

*
A mos vallë vetëm kaq ishte ky udhëtim në formën e një ditari, nëpër këtë copëz të bukur parajsore, Arbërinë? Ai është i pranishëm kudo, me gjithë vitalitetin e tij të fuqishëm e këmbëngulës, duke e trajtuar me shumë inteligjencë këtë projekt të madh, i cili është botimi i parë që vjen në këtë mënyrë e përmasë për lexuesin dhe, sigurisht, po i veçantë për historinë dhe letërsinë shqiptare, duke u pajisur me fakte dhe informacion të ri. Do të jetë një vlerë e shtuar në fondin e librit shqiptar me këtë objekt.

NGA SHAHMERANI TE ROZAFI

Filmi i ri në Netflix, *Shahmaran*, risolli vëmendjen tek legjenda jo shumë e njohur botërisht, të qenies mitologjike gjysmë grua e gjysmë gjarpër. Emër që vjen nga persishtja dhe që është bashkimi i fjalës "shah" mbret dhe "maran" gjarpër.

Nada DOSTI

Me fuqizimin e lobit që promovon ideologjinë feministe, e cila tashmë promovohet aq shumë sa që është kthyer në një mendësi, po fuqizohet edhe rrëfimtaria e mitologjisë dhe traditës popullore që promovon heroinat femra. Dimë se mitet dhe legjendat janë produkte të traditave dhe kulturave të ndryshme si përpjekje për të kuptuar fenomene të caktuara por edhe jetën në përgjithësi. Në këto rrëfime mund të gjinden shumë mesazhe të fshehura të cilat mund të jenë referencë për çështjet gjinore dhe mënyrën se si shihet dhe trajtohet gruaja në një shoqëri. Legjenda e Shahmaranit, më së shumti është e përhapur në traditën dhe kulturën kurde, iraniane dhe të Anadollit. Rrëfimi mbi Shahmaranin vjen në versione të ndryshme sipas kulturës përkatëse. Ndër këto versione mund të përmenden: "Unaza e Shah Maran, një tregim nga malet e Kurdistanit" nga Raphael Emmanuel, një tjetër version gjendet në përkthimin nga J.C. Mardrus të "Njëmijë e një net" tek përralla e titulluar "Xhemilja, Sulltaneshja e Nëntokës" si dhe "Unaza e Shah Maran, një tregim nga malet e Turqisë".

Sipas legjendës, mijëra vjet më parë, ekzistonte një specie e veçantë gjarpërinjsh që jetonin në tokë. Këta gjarpërinj, të quajtur Maran, ishin inteligjentë dhe jetonin në paqe. Mbretëresha e Maranëve quhej Shahmaran. Shahmaran ishte një grua e re e bukur. Legjenda thotë se Xhemshabi ishte personi i parë që e pa Shahmaranë. Ai ishte djali i një familjeje të varfër që shiste dru për bukën e gojës. Një ditë, Xhemshabi dhe miqtë e tij zbuluan një shpellë plot me mjalte. Shokët e tij, e zbritën Xhemshabin për të nxjerrë mjaltnin. Xhemshabi pa një vrimë në shpellë dhe vuri re që prej saj depëronte dritë. Duke e zmadhuar vrimën me një thikë në xhep, ai pa një kopsht më të bukur se sa kishte parë ndonjëherë në jetën e tij. Në këtë kopsht, ai pa lule unike, pishina dhe shumë gjarpërinj. Ai jetoi atje për shumë vite dhe fitoi besimin e Shahmaranit. Vite më vonë, ai tha se i mungonte familja e tij dhe iu lut të largohej. Shahmaran pranoi ta lironte me kusht që të premtonte se nuk do t'i tregonte askujt për vendin e saj. Xhemshabi i dha fjalën dhe shkoi të takonte familjen e tij. Për vite me radhë, ai e mbajti premtimin e tij për të mos i treguar askujt se ku ishte Shahmarani. Mirëpo një ditë u sëmur sulltani i vendit. Veziri tha se ilaçi për sëmundjen ishte ngrënia e mishit të Shahmaranit dhe lajmi u shpërnda kudo. Kur Xhemshabi iu tregoi vendndodhjen e pusit, Shahmaran u gjet dhe u nxor jashtë. Shahmarani i kërkoi të dashurit të saj të vepronte në këtë mënyrë: "Më vendos për zierje në një enë balte, jepja vezirit ekstraktin tim dhe ushqej me mishin tim sulltanit, ndërsa ujin e dytë të zierjes pije vetë". Kështu, veziri vdiq dhe sulltani u shërua dhe e bëri vezirin e tij Xhemshabin, i cili pas pirjes së ujit

përvetësoi dije pafund dhe urtësi.

Në disa versione të tjera ekzistojnë edhe elementë dhe personazhe shtesë si, për shembull, Lilith, e cila në disa kultura të lashta, njihet si gruaja e parë, madje para Havasë, e krijuar prej dheut së bashku me Ademin. Lilith, në legjendën tonë është motra e Shahmaranit, e cila pas vrasjes së saj përbe-tohet për hakmarrje. Një ditë, pas plotësimit të disa shenjave të Kiametit, do të fuqizohet dhe do të rikthehet në sipërfaqen e tokës për t'u hakmarrë ndaj racës njerëzore dhe të gjitha zullumeve të tyre jo vetëm karshi gjarpërinjve Mara por edhe natyrës në përgjithësi. Historia e Shahmaranit, qoftë filmit apo legjendës në origjinë, tregon se si njeriu tradhtoi lidhjen e tij me natyrën, duke shkaktuar vdekjen e krijesës që donte. Bëhet fjalë për një histori keqardhjeje dhe faji, dhe sipas legjendës, njerëzimi mund të shpaguej veten vetëm nëse një njeri bie sërish në dashuri me natyrën, pra nëse fillon t'ia dijë vlerat dhe të përkujdeset për të. Megjithatë, në këtë rast, njeriu do të jetë ai që sakrifikon jetën për dashurinë. Duke analizuar kuptimin e përgjithshëm të mitit, Shahmaran na jep një mësim për njerëzimin, natyrën dhe tradhtinë. Janë njerëzit fajtorët e vërtetë për mënyrën se si tradhtojnë natyrën dhe duhet të kërkojnë shpazim gjatë jetës së tyre. Me sakrificat të vogla të përditshme dhe kuptimplote, në emër të dashurisë për natyrën, ne mund të shpaguejmë fajin tonë dhe të gjejmë lidhjen tonë të përtëritë me natyrën që na rrethon.

Megjithatë, sakrificat është tema kryesore në mitologjinë në fjalë. Jo një sakrificë e rëndomtë, por pikërisht sakrificat e një gruaje. E cila është e prirur të falë dashuri dhe besim të cilat këmbehen me tradhti, me mosmbajtje fjale, deri në flijimin e saj. Pra është gruaja ajo që i vuan pasojat më së

shumti, dhe ajo që duhet të sakrifiko-het për një kauzë më madhore. Gruaja është ajo e cila përfundon viktimë e sistemit, e burrave në pushtet dhe me famë. Ajo sakrifkohet për tre burra të tjerë: vezirin, mbretin dhe i dashuri i saj. Ndoshta në këtë rast numri tre simbolizon edhe një numër në shumës dhe të tre këta karakter simbolizojnë një person të dashur që mund të jetë partneri, veziri mund të simbolizojë një person më me shumë pushtet si vëllai, dhe mbreti babain. Personazhe në jetën reale që historikisht kanë pretenduar të kenë pushtet mbi gruan si bashkëshorte, motër dhe bijë.

Ky lloj mesazhi i koduar, na kujton përveçse disa dhjetëra histori të tjera nga mitologjia greke, por veçanërisht një tjetër legjendë në trojet tona: Rozafati. Legjenda e ç'koduar flet praktikisht për një burrë plak të urtë (i cili mund të simbolizojë ndër të tjera jo vetëm dije dhe eksperiencë jete por edhe partriakalizmin) takon tre djem të cilët ankohen se dëshirojnë të ndërtojnë një kështjellë në për t'u mbrojtur nga armiqtë mirëpo ndërtojnë themelet ditën dhe iu prishen natën. Plaku iu sugjeron që duhet të sakrifikojnë pikërisht një grua (jo një fëmijë, jo një burrë, por një grua). Ai iu sugjeron gjithashtu që të mos e flasin sekretin e tyre me gratë por t'ia lënë këtë rastësisë: gruaja e parë që do vijë të nesërmen të sjellë ushqim për vëllezërit do të jetë ajo që do sakrifiko-het dhe do muroset në themelet e kështjellës. Djemtë e mëdhenj nuk e ruajnë sekretin, përveç të voglit, gruaja e cila merr përsipër t'ia çojë ushqim "trimave" pasi kunatat e saja gjejnë arsytim. Kështu, Rozafati muroset, edhe pse nënë gjidhënese, nuk ia kursyen jetën për hatër të foshnjës. Andaj, ajo pranon me kusht që gjysma e trupit t'i lihet jashtë, që të mund të vazhdojë, simbolikisht, të

kujdeset për djalin e saj. Me dorën e djathtë të mund t'ia përkëdhelë kokën, me gjirin e djathtë të mund ta mëkojë, me këmbën e djathtë të mund ta përkundë djepin. Përsëri, një tjetër grua u sakrifikua, për familjen e saj, për sigurinë e vendit dhe për të mirën e atdheut. Ajo u sakrifikua për faj të tre burrave të tjerë të familjes së saj, që në këtë rast janë bashkëshorti dhe kunetërit, shtu dhe një burrë të panjohur që kalon aty rastësisht i cili mund të jetë kushdo, madje dhe djalli vetë i mishëruar në formë njeriu.

Ekziston dhe një tjetër legjendë e jona e cila në mënyrë shumë të fshehur nxjerr në pah elementin e sakrificës, siç është ajo e Doruntinës dhe Konstantinit. Sipas legjendës, Konstandini e bind nënën që ta martojë motrën e tij Doruntinën me një njeri prej një vendi të largët, i cili po i kërkonte dorën. Konstandini i jep besën nënës se nëse atë e merrte malli për të bijën atëherë ai vetë do të shkonte e do t'ia sillte. Nëna pranon dhe e marton Doruntinën me burrin nga vendi i largët. Por ndërkohë vdesin të gjithë vëllezërit, përfshirë dhe Konstantinin dhe nëna mbetet e vetme. Atë e merr malli për Doruntinën dhe merrzitet shumë. Shkon te varri i Konstantinit dhe e mallkon të birin që kishte shkelur besën. Në mesnatë Konstantini ngritet nga varri, shkon e merr motrën dhe ia sjell nënës te dera. Për vete kthehet në varr ndërsa Doruntina troket në derë pa e ditur se i vëllai kishte vdekur. Kur hapet dera, nëna e pyet atë se kush e solli, e ajo i thotë Konstantini. Nëna i tregon se Konstantini bashkë me vëllezërit e tjerë kishin vdekur shumë kohë më parë. Kjo është çka ne dijmë apo çka përsëritet shpesh nga versione të ndryshme të legjendës si tek "Përralla të Moçme" të Mitrush Kutelit, apo "Kush e solli Doruntinën" të Ismail Kadaresë. Por nën rreshta mund të lexohet një mesazh fatal: e gjithë kjo tragjedi erdhi si pasojë e vendimit që vëllezërit morën pa pëlqimin e nënës dhe motrës së tyre, për ta martuar Doruntinën pikërisht në atë vend të largët sepse martesë do të sillte pajtim gjakrash, paqe dhe bashkëpunim në të ardhmen.

*"Pa m'ingjoni vllaznit e mi,
sall ni motër tjetër spat,
si u kujtuet n'Kraji mem tret?"*

Martesa në fjalë, ishte kështu një strategji lufte dhe përsëri një grua sakrifkohet nga vëllezërit e saj për hir të disa interesave "më madhore dhe fisnike". Që prej asaj kohe e deri në ditët e sotme gratë sakrifkohen përditë. Kush për faj të bashkëshortit, kush për faj të babait apo vëllezërve, apo dhe nga sistemi në përgjithësi. Andaj, rrëfimi i baladave dhe legjendave duhet zhbërë dhe ribërë në një formë më të shëndetshme, jo vetëm për të mirën e grave, por të shoqërisë në përgjithësi. Mitologjitë janë ADN-ja e një populli dhe përcakton dhe të ardhmen e tij, nëse nuk mësojmë t'i rithemi legjendat tona, duke marr parasysh drejtësinë hyjnore dhe barazinë gjinore.



NUMRI I ARDHSHEM ME 20 SHKURT

HEJZA

10 SHKURT, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtore: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000